



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË NË MAQEDONINË E VERIUT DHE NË RAJON PËRMES INDEKSIT TË TRANSPARENCËS

KUVENDI DHE PUSHTETI EKZEKUTIV

Fondacioni Metamorfozis


2022

METAMORPHOSIS 

 **ActionSEE**

Ky vlerësim është prodhuar nga Metamorphosis Foundation me mbështetje e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë vlerësim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky dokument është pjesë e projektit të financuar nga Fondacioni nacional për demokraci (NED). Qëndrimet dhe mendimet e cekura në këtë dokument i pasqyrojnë mendimet e autorëve dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e donatorëve.



**VLERËSIMI I
QEVERISJES SË MIRË
NË MAQEDONINË
E VERIUT DHE NË
RAJON PËRMES
INDEKSIT TË
TRANSPARENCËS**

KUVENDI DHE PUSHTETI EKZEKUTIV

Fondacioni Metamorfozis

Sipas matjes për vitin 2021
Shkup, gusht 2022



PËRMBAJTJA

SHKURTESA	7
1. HYRJE	11
2. METODOLOGJIA	13
3. TRANSPARENCA E KUVENDEVE NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	15
3.1. TRANSPARENCA E KUVENDEVE NË RAJON	15
3.2. TRANSPARENCA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	22
3.2.1 Transparenca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	23
3.2.2 Të dhënat e hapura	24
3.2.3 Transparenca financiare	25
3.2.4 Qasja në informatat me karakter publik.....	25
3.2.5 Konsultimet publike	26
3.2.6 Bashkëveprimi me qytetarët.....	26
3.2.7 Integriteti	27
3.2.8 Monitorimi, vlerësimi dhe planifikimi strategjik.....	28
3.2.9 Plan gjithëpërfshirës për qeverisjen e mirë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	28
4. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	31
4.1. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON	31
4.2. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË MAQEDONINË E VERIUT	35
4.2.1 Transparenca	39
4.2.1.1. Informata organizative	40
4.2.1.2. Buxheti	42
4.2.1.3. Procedura për prokurime publike	43
4.2.2. Qasshmëria	45
4.2.2.1. Qasja në informatat	46
4.2.2.2 Bashkëveprimi me qytetarët	47
4.2.2.3. Konsultime publike	49
4.2.3 Efikasiteti (planifikimi strategjik, njoftimi, monitorimi dhe evaluimi)	50
4.2.4. Integriteti	52
4.2.5. Të dhënat e hapura	55
4.2.6. Konkluzion	57
4.2.7. Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë për pushtetin ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	58
Aneksi 1: Lista e renditjes e institucioneve me shkallë të përmbushjes së treguesve të transparencës.....	62
Aneksi 2: Lista e renditjes e institucioneve me shkallë të përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura.....	64



SHKURTESA

ACTION SEE – Llogaridhënia, teknologjia dhe rrjeti i transparencës institucionale në Evropën Juglindore

RVNE – Regjistri i vetëm nacional elektronik i rregullave

QLI – Qasja e lirë në informata me karakter publik

BdhH – Bosnja dhe Hercegovina

OC – Organizata Qytetare

CV – Curriculum vitae/Jetëshkrimi

BE – Bashkimi Evropian

FBdhH – Federata Bosnja dhe Hercegovina

LQLIKP – Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik

GREKO – Grupi i shteteve kundër korrupsionit (The Group of States against Corruption-GRECO)

MNR – Mekanizmi Ndërkombëtar i Raportimit

GPNP – Grupi Parlamentar Ndërpartiak

NATO – Aleanca Veriatlantike

PQH – Partneriteti për Qeveri të Hapur

OECD – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

OSBE/ODIHR – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR)

OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)

RIA – Vlerësimi i Ndikimit të Rregullativës (Regulatory Impact Assessment - RIA)

TAIEX – Instrumenti për Ndhmë Teknike për Këmbim të Informatave të Komisionit Evropian

Titulli origjinal: Проценка на доброто владеење во Северна Македонија и регионот преку Индексот на отвореност
СОБРАНИЕ И ИЗВРШНА ВЛАСТ Според мерењето за 2021 година

© 2022 Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis

Shkup, gusht 2022

Botues: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, rr. „Apostoll Gusllarot“ nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Autor: Dançe Danillovska Bajdevska (Данче Даниловска Бајдевска), Nada Naumovska (Нада Наумовска), Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis (Фондација за интернет и општество „Метаморфозис“)

Redaktor: Bardhyl Jashari, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, (Бардил Јашари, Фондација за интернет и општество „Метаморфозис“)

Përkthyes (nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe): Bestel DOOEL Skopje (Maqedonia e Veriut)

Dizajni: Royal Art (Maqedonia e Veriut)

Shtypi: Polyesterday (Maqedonia e Veriut)

Tirazhi: 65 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

342.53:005.332.5(497.7)“2021”(047.31)

342.51:005.332.5(497.7)“2021”(047.31)

DANILLOVSKA Bajdevska, Dançe

Vlerësim i qeverisjes së mirë në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon përmes Indeksit të shkallës së hapjes : Kuvendi dhe pushteti ekzekutiv :

sipas matjes për vitin 2021 / [autor Dançe Danillovska Bajdevska, Nada Naumovska ; redaktor Bardhyl Jashari]. - Shkup : Fondacioni Metamorfozis, 2022. - 70 стр. ; 30 см


Превод на делото: Проценка на доброто владеење во Северна Македонија и регионот преку Индексот на отвореност : Собрание и извршна власт : според мерењето за 2021 година / Данче Даниловска Бајдевска, Нада Наумовска. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-093-9

1. Naumovska, Nada [автор]


а) Собрание -- Транспарентност -- Македонија -- 2021 -- Истражувања б)
Извршна власт -- Транспарентност -- Македонија -- 2021 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 58045189




Me përkrahjen e Projektit për pjesëmarrje qytetare të USAID-it, Fondacioni Metamorfozis në bashkëpunim me partnerët e rrjetit rajonal të OQ – Llogaridhënie, teknologji dhe rrjeti i transparencës institucionale në Evropën Juglindore (ACTION SEE)¹, përpiloi vlerësim të gjendjes së sundimit të mirë të kuvendeve dhe degëve ekzekutive të pushteteve qendrore të katër vendeve të Ballkanit Perëndimorë – Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina. Vlerësimi është rezultati i hulumtimit gjithëpërfshirës empirik i bazuar në Indeksin e transparencës², që ka për qëllim përcaktimin e shkallës së respektimit të parimeve të sundimit të mirë në rajon. Ky punim jep një analizë të thelluar të punës së pushtetit ekzekutiv dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por jep edhe një rezymë të performansave të përgjithshme të institucioneve përkatëse në rajonin tonë. Perspektiva rajonale shërben si referencë për atë se si avancojnë shtetet e rajonit drejt përmirësimit të sundimit të mirë dhe sundimit të së drejtës që i shpie drejt qëllimit të tyre strategjik – anëtarësimi në BE.

Punimi është i pasuruar edhe me rekomandime praktike për atë se si pushteti ekzekutiv dhe Kuvendi në Maqedoninë e Veriut mund ta përmirësojnë respektimin e parimeve të sundimit të mirë në të ardhmen. Rekomandimet do t'u kumtohen edhe nëpunësve të lartë shtetëror në të gjitha institucionet e mbikëqyrura përmes takimeve, si dhe publikut të gjerë përmes mediave sociale dhe mbajtjes së evenimenteve publike.



-
- 1 Llogaridhënie, teknologji dhe rrjeti i transparencës institucionale në Evropën Juglindore është rrjet i organizatave qytetare të cilat punojnë së bashku për promovimin dhe sigurimin e përgjegjësisë dhe transparencës së pushtetit në rajonin e Evropës Juglindore, ngritjen e potencialit të aktivizimit qytetar dhe pjesëmarrjes qytetare, promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Internet dhe ndërtimit të kapaciteteve dhe interesit të organizatave qytetare dhe individëve në rajon, për shfrytëzimin e teknologjisë gjatë punës për avancimin e demokracisë.
 - 2 Indeksi i transparencës përbëhet prej katër komponentëve të ndryshëm - (1) transparencë, (2) qasje, (3) integritet dhe (4) efikasitet, ku secila prej tyre mat transparencën e degëve të ndryshme të menaxhimit: pushtetit lokal, pushtetit qendror, gjyqësisë dhe kuvendit.



1. HYRJE

Republika e Maqedonisë së Veriut i vazhdoi përpjekjet e saj për forcimin e demokracisë dhe sundimit të së drejtës, përfshirë edhe aktivizimin e mekanizmave ekzistues të “kontrollit dhe baraspeshës” si dhe përmes qasjes deri te politikave dhe çështjet ligjvënëse kyçe, ka konstatuar Komisioni Evropian në Raportin për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021. Në esencë, institucionet e treguan përkushtimin e tyre për arritjen e rezultateve në sferat kryesore të klasterit Themele, përfshirë edhe përmes agjendës “Evropa në shtëpi” dhe “Aksioni 21” për luftimin e korrupsionit.³ Por, megjithëse Komisioni, në Strategjinë për zgjerim përsëri rekomandon fillimin e negociatave – miratimin e kornizës negociuese dhe mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë deri në fund të vitit 2021, duke pohuar se prolongimi ka ndikim negativ ndaj kredibilitetit të BE-së, prapë se prapë procesi i aderimit të Maqedonisë së Veriut është “robëruar” nga bllokada e vendosur nga Republika e Bullgarisë. Si përgjigje ndaj ngecjes së negociatave aderuese, vendi u orientua drejt bashkëpunimit të rritur rajonal, përmes iniciativës “Ballkani i Hapur”.

Në janar të vitit 2022 u zgjodh Qeveria e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila mori përsipër obligimin se “do të udhëhiqet nga parimet themelore dhe progresive të qeverisjes së mirë edhe atë përgjegjësisë, efikasitetit, llogaridhënie, punë ë ndershme, inkluzivitetit dhe arritshmëri.⁴ Karakteristikë e cila duhet të shënohet në përbërjen e Qeverisë së re është edhe zgjedhja e Zëvendëskryetarit të Qeverisë, i ngarkuar për politikave të sundimit të mirë, që është i paraparë me qëllim që “krijimi dhe implementimi i politikave të sundimit të mirë të jenë imperativ, në drejtim të sigurimit të profesionalizmit, efikasitetit dhe transparencës në shoqëri.⁵


Ky punim e analizon transparencën e institucioneve të pushtetit qendror në Maqedoninë e Veriut dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2021. Duke marrë parasysh se transparenca është kusht kryesor për demokraci, meqë qytetarëve u mundëson t’i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efikase dhe përgjegjësi të institucioneve për politikave që i zbatojnë, në këtë punim në bazë të analizës së gjendjes, u janë dhënë rekomandime institucioneve për atë se si duhet t’i përmirësojnë performancat e tyre.

Analiza dhe rekomandimet e dhëna në këtë dokument, do të shërbejnë si bazë e aktiviteteve për përfaqësim, të cilat do të ndërmerren nga Fondacioni Metamorfozis, me qëllim të avancimit të parimeve të menaxhimit të mirë të institucioneve. Hulumtimi përsëritet në nivel vjetor dhe na mundëson që ta krahasojmë shkallën e veprimit sipas rekomandimeve të dhëna paraprake. Informatat dhe të dhënat e rezultateve veçmas dhe në mënyrë krahasimtare sipas institucioneve në Maqedoninë e Veriut dhe vendeve të rajonit, mund të merren në ueb faqen <https://index.actionsee.org/>.

3 Raporti i Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 i Komisionit Evropian. Sekretariati për Çështje Evropiane. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/SKKZ18g>

4 Programi i punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/ËKKSjQK>

5 Ibid.



2. METODOLOGJIA

Vlen të theksohet se edhe krahas faktit që nocioni qeverisje e mirë shpeshherë përdoret në diskursin politik dhe në analizën e politikave, ai mbetet një koncept fluid pa një përkufizim të qartë. Kuptimi i tij kryesisht formësohet sipas qëllimit që shfrytëzohet dhe komponentët në të cilat fokusohet. Interpretimi i pranuar gjerësisht është se ky nocion ka të bëjë me sistemin e sundimit që jep rezultate të cilat i përmbushin nevojat e shoqërisë përmes shfrytëzimit më të mirë të resurseve në dispozicion.

Ky përkufizim përkon me standardet që zbatohen në demokracitë liberale perëndimore, që janë simbol dhe udhërrëfyes për vendet në zhvillim, siç është Maqedonia e Veriut.

Indeksi i transparencës udhëhiqet sipas kësaj kornize të parimeve, por megjithatë është i vetëdijshëm për ngjarjet kulturore dhe historike të vendit dhe rajonit, të cilat ndikojnë edhe në institucionet. Metodologjia e tij garanton se rezultatet e hulumtimit janë të vlefshme në aspekt teknik dhe politik, prej të cilave mund të nxirret konkluzion në lidhje me sundimin e mirë të institucioneve të vendit. Indeksi i transparencës i vlerëson performancat e pushtetit ekzekutiv dhe kuvendeve nga sfera e sundimit të mirë, më atë që fokusohet në katër shtylla: (1) qasshmëria, (2) efikasiteti, (3) integriteti dhe (4) transparenca me një domen të përbashkët të pranishëm në të katër shtyllat – të dhënat e hapura.

Katër shtyllat e Indeksit të transparencës e përkufizojnë dhe vlerësojnë sundimin e mirë së bashku me parimet në vijim: **qasshmëria** – e vlerëson shkallën deri në të cilën është e garantuar me ligj qasja në informata, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultime gjatë proceseve të krijimit të politikave; **efikasiteti** – e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset vijuese dhe për t'i përmirësuar përmes sistemeve të vendosura për monitorim, vlerësim dhe mësim – duke përdorur pikat kyçe / indikatorët gjatë planifikimit dhe informimit strategjik; **transparencë** – e vlerëson arritshmërinë publike të informatave organizative, buxhetit dhe procedurave për prokurime publike, ndërsa **integriteti** e vlerëson prezencën e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesave, rregullimin e lobimit, si dhe arritshmërinë e kodit të sjelljes etike që do ta udhëheqë dhe sanksionojë sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe administratës publike. Çdo shtyllë e Indeksit përbëhet nga nëndomenet dhe indikatorët e matur sipas vlerës përkatëse në kuadër të atyre shtyllave.

Metodologjia u zhvilluar në konsultim me një numër të madh të resurseve të besueshme, duke i potencuar praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të sundimit të mirë, siç është Banka Botërore dhe Instituti, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Ekonomik, Udhëzuesi për Qeveri të hapur, Raporti për integritet global dhe Indikatorët për sundim dhe kualitet institucional të zhvilluara nga Banka Botërore.

Hulumtimi është realizuar në periudhën janar 2022 dhe mars 2022. Ekzemplari i institucioneve të targetuara përbëhet nga gjithsej 51 institucione, përfshirë edhe Qeverinë/Sekretariatit e Përgjithshëm 16 ministri dhe 33 organe të zgjedhura në mënyrë të rastësishme, që janë në përbërje të ministrive, si dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Metodatat e hulumtimit përbëhen nga (1) monitorimi i ueb faqeve të institucioneve të targetuara, sipas një sërë indikatorësh, (2) pyetësi dorëzuar institucioneve për të konfirmuar konstatimet nga monitorimi online, (3) kërkesa për qasje në informatat me karakter publik dërguar çdo institucioni me qëllim për të vlerësuar shkallën e përbushjes së kësaj të drejte themelore nga secili institucion, si dhe (4) kontrolli i kornizës ligjvënëse.

Gabimi në matje është +/- 3%. Në bazë të rezultateve të hulumtimit, realizuam analizë me pikat dhe problemet kryesore kritike në sferën e transparencës së institucioneve, të cilat shpresojmë se do të shfrytëzohen për përmirësimin e punës së tyre.

Është me rëndësi të përmendet se në rastet kur institucionet nuk i kanë dorëzuar pyetësorët e hapur, indikatorët për këtë ishin shënuar me 0, si indikatorë që nuk janë përbushur. Gjegjësisht, prej 50 institucione të targetuara të pushtetit ekzekutiv, 30 (60%) i janë përgjigjur pyetësorit, ndërsa 20 të tjerë (40%) në mënyrë automatike marrin 0 sipas indikatorëve përkatës. Prej institucioneve që nuk i janë përgjigjur pyetësorit, 4 ishin ministri (Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve) dhe 16 ishin organe ekzekutive. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i është përgjigjur këtij pyetësori.

3. TRANSPARENCA E KUVENDEVE NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3.1. TRANSPARENCA E KUVENDEVE NË RAJON

Viti i kaluar u karakterizua me situata të ndryshme politike që reflektuan edhe në punën e trupave ligjvënëse në rajon. Parlamentet e rajonit kryesisht nuk punuan me dokumente dhe politika strategjike që do të kontribuojnë për transparencën e tyre, e që zakonisht kishin bllokada, kriza ose aktivitete që nuk kishin për qëllim demokratizimin më të madh të shoqërisë. Për këtë dëshmojnë edhe konstatimet e hulumtimit tonë që tregojnë se institucionet ligjvënëse, megjithëse të hapura deri në një shkallë të caktuar, kanë bërë vetëm disa hapa për të përmirësuar transparencën e tyre. Kështu, edhe më tutje vërehen dukuritë si mbledhje jo mjaft transparente të komisioneve, praktika jo mjaft të zhvilluara antikorruptive, për të cilat qeveritë punojnë shumë pak ose fare s'punojnë, si dhe dukuria e mekanizmave kontrolluese të cilat nuk zbatohen mjaftueshëm. Para se të japim informata të detajuara për këto çështje, do të japim pasqyrë të gjendjeve në institucioneve ligjvënëse në rajon, me qëllim për të kuptuar më mirë kontekstin në të cilin kanë punuar këto institucione gjatë vitit të kaluar.

Puna e ngadalësuar dhe bllokatat e institucioneve ligjvënëse në Bosnjë dhe Hercegovinë

Asambleja parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2021 vazhdoi me aktivitete tejet të dobëta parlamentare, ndërsa këtë vit u shënuar rezultat shumë më të keq në raport me periudhën e kaluar të raportimit. Shtëpia e përfaqësuesve të Asamblesë parlamentare të Bosnjës dhe mbajti vetëm 12 seanca, ndërsa Dhoma e popujve mbajti vetëm 8 seanca, prej të cilave 2 ishin urgjente. Arsye për aktivitetin e dobët parlamentar në këtë nivel të pushtetit ishte vendimi i deputetëve të Republikës Serbe që të mos vijnë në seancat e Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës, pas ndryshimeve të Kodit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës nga ana e Zyrës së përfaqësuesit të lartë. Gjegjesisht, përfaqësuesi i lartë Valentin Incko e shfrytëzoi tërë fuqinë e tij që të bëjë ndryshime në kodin penal të vendit, për të ndaluar mohimin e gjenocidit dhe glorifikimin e kriminelëve të luftës. Incko i imponoi ndryshimet në kuadër të të a.sh. "autorizimeve të Bonit", të cilat i lejojnë përfaqësuesit të lartë që ta tejkalojë obstrukcionin e legjislacionit nga ana e politikanëve boshnjakë, nëse ajo është me rëndësi vitale për ruajtjen e paqes. Ndryshimet ligjore u hodhën poshtë nga liderët politikë në Republikën Serbe, ku ata kërkuan që të shfuqizohet pozita e përfaqësuesit të lartë.

Kuvendi Popullor i Republikës Serbe, mbajti 6 seanca të rregullta dhe 9 të posaçme, në të cilat u miratuan 48 zgjidhje ligjore. Pasi përfaqësuesi i lartë i miratoi ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës, kjo dhomë ligjvënëse e miratoi edhe Ligjin për moszbatimin e vendimit të përfaqësuesit të lartë për miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës Serbe. Me ndryshimin e Ligjit definohet “Shkelja e dinjitetit të Republikës Serbe dhe popujve të saj”, ndërsa siç është theksuar në nenin e shtuar të Kodit, “nëse Republika Serbe është shënuar si agresor ose entitet gjenocid ose edhe popujt e saj si agresorë ose entitete gjenocide, kryerësi do të dënohet me paraburgim nga gjashtë muaj deri në pesë vite.” Në dhjetor, Kuvendi popullor i Republikës Serbe e miratoi informatën për “kalimin e kompetencave nga Bosnja dhe Hercegovina në nivel të Republikës Serbe” në sferën e tatimit indirekt, drejtësisë, mbrojtjes dhe sigurisë, ndërsa parapra kisht në dhjetor e miratoi Ligjin për barëra dhe preparate mjekësore me të cilat parashihet formimi i subjektit të Agjencisë së barërave. Nga viti 2009, kjo agjenci funksionon në nivel shtetëror.

Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës nuk ishte shumë më aktiv se vitin 2020, ndërsa shumica parlamentare e kësaj shtëpie nuk funksionon siç duhet që nga zgjedhjet e vitit 2018, me ç’rast nuk ishte formuar Qeveria e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, duke punuar kështu me mandat teknik. Arsyeja më e madhe për mospasjen e një dinamike më të madhe të punës në këtë nivel të pushtetit është mospasja për të arritur marrëveshje në aspekt të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të Bosnjës dhe Hercegovinës, që praktikisht ishte e kushtëzuar nga Komuniteti demokratik kroat në Bosnjë dhe Hercegovinë, për të formuar një qeveri të re pas zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2018. Gjatë vitit 2021, Dhoma e përfaqësuesve e këtij trupi ligjvënës ka mbajtur 10 seanca të rregullta dhe 2 të posaçme. Dhoma e popujve e Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës është mbledhur 15 herë dhe ka mbajtur 9 seanca.

Modernizimi i kanaleve të komunikimit, por miratimi i ligjeve me procedurë urgjente, mbetet problem në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Të zgjedhur përmes sistemit zgjedhor proporcional me lista partiake të njësive zgjedhore, në periudhën 2020–2024, Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë, i përzier në aspekt gjinor dhe etnik. Sipas përbërjes së fundit, numri i deputeteve (47 nga 12, respektivisht 39%) është ulur për një në raport me legjislaturën paraprake. Numri i deputetëve nga partitë joshumicë është më i lartë deri më tani (42, respektivisht 35%).⁶

Njësoj sikur vitin e kaluar, Kuvendi vazhdoi me nivelin e lartë të transparencës administrative, i dyti pas parlamentit të Malit të Zi. Në vitin 2021, puna e Kuvendit ishte penguar nga polarizimi politik i plotësuar me KOVID-19, që ndonjëherë ndikonte edhe në funksionet e zakonshme. Në vitin e parë të pandemisë 2020, deputetët kaluan 45 ditë pune në seancat plenare dhe 77 ditë gjatë vitit 2021. Kuvendi debatoi për 376 propozim-ligje dhe miratoi 213, prej të cilëve 81 me procedurë urgjente. Megjithatë, disa ligje kryesore, përfshirë edhe draftet e ligjeve të propozuara si pjesë e Strategjisë

6 Raporti për Maqedoninë e Veriut 2021. Komisioni Evropian. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/iKXleMi>

së tanishme për reforma në gjyqësi, janë të bllokuara në procedurën e Kuvendit, pa përkrahje politike dhe pa konsensus. Komisioni Evropian bëri thirrje që të kushtohet vëmendje më të madhe gjatë shfrytëzimit të procedurave të shpejta, të cilat duhet të kufizohen për të siguruar kontroll efektiv dhe konsultime të legjislacionit.⁷ Trupat e punës të Kuvendit organizuan 7 debate publike, por nuk u mbajt debat mbikëqyrës në vitin 2021. Kështu, funksioni mbikëqyrës i parlamentit është i padobishëm dhe është zbatuar vetëm përmes 8 seancave të mbajtura për pyetje deputetësh.

Kuvendi gjithashtu e miratoi edhe Planin e tij të dytë të veprimit për Partneritet për Qeveri të Hapur (PQH) për vitin 2021-2023 dhe për herë të parë iu bashkëngjiti si anëtar i Këshillit për Koordinimin dhe Monitorim të Planit të Veprimit për PQH 2021-2023. Këshilli është trup me disa palë të interesuara, i përbërë prej 16 anëtarësh, të përfaqësuar barazisht nga organizatat qytetare dhe institucionet.

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti të politikave, në vitin 2022, Kuvendi e përditësoi dhe modernizoi ueb faqen, me çka e lehtësoi qasjen në informatat në pronësi të Kuvendit dhe me këtë kontribuoi që puna e tyre të jetë më transparente. Ky hap është paraparë për të mundësuar përvojë më të mirë për shfletim të qytetarëve dhe mundësi për transmetim në kanal in e ri të Kuvendit, ku Kuvendi ka për qëllim të ofrojë emisione debutuese dhe produksion personal. Siç u tha publikisht, në kuadër të qëllimeve strategjike të Kuvendit është edhe implementimi i një softueri për monitorim, i cili mundëson ndjekjen e progresit të miratimit të ligjit që ka hyrë në procedurën e Kuvendit përmes ueb faqes së Kuvendit, që çdo subjekt ta dijë statusin e ligjit, ku duhet të përfaqësohen dhe lobohen, si dhe para kujt.

Kriza politike dhe bllokada e Parlamentit të Malit të Zi

Parlamenti i Malit të Zi, tradicionalisht arrin nivel të lartë të transparencës administrative. Kjo është konstatuar edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian, duke potencuar se është përmirësuar transparenca dhe komunikimi me publikun. Parlamenti i Malit të Zi ka vendosur praktika pozitive siç janë transmetimi i seancave në TV kanal in e posaçëm parlamentar, ndërsa vitin e kaluar janë vendosur edhe peticione elektronike. Mirëpo, në vitin e kaluar Parlamenti nuk arriti që ta përforcojë transparencën dhe inkluzivitetin gjatë procesit ligjvënës. Në këtë nuk ndihmoi as edhe kriza politike, që në një moment solli deri te ajo që opozita më e madhe dhe partia në pushtet ta bojkotojnë punën e këtij institucioni, që paraqet ngjarje pa precedent. Pothuajse i tërë Parlamenti për një moment nuk e përkrahu Qeverinë, që më pas çoi në votimin e mocionit ndaj Qeverisë së Zdravko Krivokapiq. Pas një krize tremujore gjatë së cilës Parlamenti ishte tërësisht i bllokuar, në prill të vitit 2022 u zgjodh Qeveri e re dhe kryetar të Parlamentit.

Problemet kryesore në këtë periudhë të funksionimit të Parlamentit janë të lidhura me mospasjen e Ligjit për Parlament, për çka edhe ishimi dëshmitar të situatave tejet kreative në të cilat Parlamenti është i pafuqishëm në rolin kontrollues dhe në të cilin individit e bllokoi punën e Parlamentit.

7 Ibid.

Mungesa e vullnetit politik për miratimin e Ligjit për Parlamentin dhe Ligjit për Qeverinë, sollli deri te lëshime të konsiderueshme dhe ngecje të zhvillimit të raporteve ndërmjet institucioneve kyçe demokratike. Ajo është gjithashtu një pengesë e konsiderueshme për krijimin e një baraspeshe ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës siç është e proklamuar me Kushtetutën e Malit të Zi.⁸

Parlamenti njëpartiak miratoi Kushtetutë të re

Konvokimi i dymbëdhjetë i Kuvendit Nacional u konstitua në tetor të vitit 2020, ndërsa Presidenti i shtetit (gjithashtu lider i koalicionit që ka madje 97 % të deputetëve në parlament), publikoi në fjalimin e tij pas konstituimit të parlamentit, se ky proces do të zgjasë rreth një vit e gjysmë. Ky njoftim u tregua si i vërtetë, sepse zgjedhjet e përgjithshme u realizuan më 3 prill 2022, ndërsa përbërja e tanishme është aktive më pak se dy vite. “Parlamenti pothuajse një partiak është rezultat i bojkotit të zgjedhjeve parlamentare nga ana e partive opozitare. Për ta tejkaluar krizën politike të shkaktuar nga kjo situatë, paralelisht janë mbajtur dy dialogë ndërpartiakë nën patronazhin e Kryetarit të Kuvendit, njëra me përfaqësuesit e opozitës, të cilët u dakorduan që të negociojnë më mirë për kushtet zgjedhore me autoritetet, ndërsa tjetra me partitë opozitare të cilat kërkojnë ndërmjetësimin e BE-së. Gjatë seancës vjeshtore, të dy proceset përfunduan me marrëveshje ndërmjet pjesëmarrësve dhe me miratim të ndryshimeve të para të ligjeve me të cilët rregullohet puna e mediave, para fundit të dhjetorit 2021, si rrjedhojë e këtyre marrëveshjeve.”⁹

Gjatë vitit 2021 u realizua procesi i ndryshimit të Kushtetutës, pas prolongimeve disavjeçare. U krijua përshtypja megjithëse formalisht respektohen procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e aktit më të lartë shtetëror, kualiteti i vendimeve të miratuara nuk do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e pavarësisë së gjyqësisë, të cilat ishin arsye kryesore për ndryshimin dhe plotësimin e këtij akti.

„Procesi i ndryshimit të Kushtetutës në pjesën që ka të bëjë me pavarësinë e gjyqësisë, pas disa viteve prolongim, filloi në seancën pranverore dhe rezultoi me miratimin ekspres të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës, pas vetëm gjashtë muajsh. Grupi i punës, i formuar nga Komisioni për Çështje Kushtetuese dhe Legjislacion anëtarë të të cilit ishin përfaqësues të posaçëm të shoqatave profesionale, kishte afat prej dy muajsh që ta përpilojë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës. Propozimi u prezantua para publikut në fillim të shtatorit, në katër debate publike të organizuara nga Kuvendi, pas të cilave në ditën e fundit të nëntorit edhe u miratuan nga ana e Kuvendit. Të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit shpalli referendum për konfirmimin e këtij ligji, i cili u mbajt më 16 janar të vitit 2022. Mbeti vetëm një muaj e gjysmë që publiku të njoftohet me rëndësinë e ndryshimeve të Kushtetutës dhe ndryshimeve në gjyqësi”.¹⁰

Gjithashtu, në seancën vjeshtore të Kuvendit Nacional u miratua Ligji i ri për referendum dhe iniciativë popullore, sipas të cilit, mes tjerash, ishte shfuqizuar pragu për referendum,

8 Ligjet për Parlamentin dhe Qeverinë janë parakusht për krijimin e sistemit demokratik. Qendra për transicione demokratike. E marrë nga <https://cutt.ly/BKXzcRP>

9 Buletini „Kuvendi nën Ilupë“ / edicioni i 17-tw, shtator-dhjetor 2021. CRTA. E marrë nga: <https://cutt.ly/FKXbAdu>

10 Ibid.

që në praktikë nënkupton se më nuk ka rëndësi se sa votues të paraqitur do të dalin në referendum për të vendosur për diçka të rëndësishme për të gjithë qytetarët. Miratimi i ligjit u ndoq me protesta të lëvizjeve ekologjike, të cilat theksonin se kjo është një prej dy ligjeve që e kanë hapur rrugën e kompanisë ndërkombëtare Rio Tinto për të hapur minierë të litiumit në Serbinë perëndimore.¹¹ Pas disa bllokadave, dispozitat e kontestueshme u mënjanuan nga propozim-ligji.

Ligji i dytë kontrovers, për të cilin protestonin lëvizjet ekologjike dhe ndryshimet e të cilit ishin në procedurën e Kuvendit në seancën vjeshtore 2021 – Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekspropriim, Qeveria e tërhoqi nga procedura pasi Kryetari refuzoi ta nënshkruaj, megjithëse nuk ka autorizim ligjor që ta bëjë këtë.

Në aspekt të ligjeve që e përmirësojnë transparencën dhe hapjen e institucioneve, në nëntor të vitit 2021 u miratuan ndryshimet e Ligjit për qasje të lirë në informatat me rëndësi publike, më shumë se pesë vite pas formimit të grupit të parë të punës për ndryshimin e këtij ligji. Sipas informatave nga mediat, organizatat që morën pjesë në procesin e konsultimeve publike, konsiderojnë se teksti i miratuar i ka zgjidhur vetëm pjesërisht problemet e potencuara gjatë zbatimit të Ligjit për qasje të lirë në informatat me rëndësi publike.¹² Vërejtjet kryesore janë se zgjidhjet e miratuara nuk e zgjidhin në mënyrë adekuate problemin me moszbatimin e vendimeve të Komisarit, si dhe se ndryshimet nuk e adresojnë në mënyrën e duhur nevojën për një transparencë më të madhe proaktive të organeve shtetërore.

Transparenca e pushtetit ligjvënës në rajon

Parlamentet e rajonit mesatarisht plotësojnë 62% të kriterëve për transparencë. Në vendin e parë është Parlamenti i Malit të Zi i cili plotëson 85,45% të kriterëve për transparencë, më pas Parlamenti i Maqedonisë së Veriut me 71,89%, më pas Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës me 61,22% (Dhoma e përfaqësuesve me 61,71%, Dhoma e Popujve me 60,74%) dhe Kuvendi Popullor i Serbisë me 51,9% transparencë.

Kuvendi Popullor i Republikës Serbe plotëson 42,28%, Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës me 33,27% (Dhoma e përfaqësuesve me 26,61%, Dhoma e Popujve me 39,93%), ndërsa Kuvendi i Krahinës Autonome të Vojvodinës plotëson 29,1% të treguesve për transparencë.

Ky rezultat nuk është i kënaqshëm, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për organe që janë zgjedhur drejtpërdrejt dhe përgjegjës para qytetarëve. Domenet më të dobëta që i hasin parlamentet janë vetëdija dhe qasshmëria, e që duhet të trajtojnë çështje siç janë ndikimi i akteve ligjore ekzistuese dhe atyre të përgatitura, pjesëmarrja dhe raportet nga aktivitete mbikëqyrëse (dëgjimet), si dhe udhëzimet për shprehjen e shqetësimit, ankesave dhe ankesave administrative që duhet të jenë të arritshme në ueb faqe, programet e arsimit qytetar, etj.

11 Serbi, ligjet dhe vullneti i popullit: Janë miratuar ndryshimet e Ligjit për referendum dhe është plotësuar kushti i protestave ekologjike. BBC News. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/KKXmhY4>

12 Ligji i ri për qasje në informatat me karakter publik; mundësi e lëshuar për përmirësimin e konsiderueshëm të publicitetit të punës së institucioneve publike. Partnerë për ndryshime demokratike në Serbi. E marrë nga: <https://cutt.ly/nKXmVëx>

Në fillim të hulumtimit, e cila përmban pjesë kualitative dhe kuantitative, hulumtuesit institucioneve u dërguan pyetësorë, si dhe kërkesa për qasje të lirë në informatat me karakter publik, për të hulumtuar se si dhe në çfarë periudhe kohore institucionet janë të gatshëm t'u përgjigjen këtyre kërkesave. Kështu, kërkesës për qasje të lirë në informatat, i janë përgjigjur: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i krahinës autonome të Vojvodinës, Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës – dhe Dhoma e Përfaqësuesve dhe Dhoma e Popujve dhe Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës – Dhoma e Përfaqësuesve. Parlamenti i Federatës së Bosnjës e Hercegovinës – Dhoma e Popujve dhe Kuvendi Popullor i Republikës Serbe aspak nuk u janë përgjigjur fare kërkesave për qasje të lirë në informata, ndërsa Parlamenti i Malit të Zi është përgjigjur, por jo në afatin ligjor. Pyetësorit iu përgjigjen të gjitha institucionet përveç Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës – Dhoma e Përfaqësuesve.

Parlamentet kanë rol kryesor në sistemin demokratik dhe prandaj duhet të jenë bartës të procesit i cili do t'u mundësojë qytetarëve monitorim më efektiv të punës së institucioneve. Mirëpo, siç është rasti edhe me pushtetin ekzekutiv, trupat më të larta ligjvënëse rajonale nuk kanë qasje strategjike ndaj politikës së transparencës. Kërkesat për transparencë mund të merren tërthorazi nga Kushtetuta, Rregullorja dhe aktet tjera, ku si të tilla janë objekt i interpretimeve të ndryshme dhe disponimit të shumicës parlamentare. Informatat për punën parlamentare i takojnë publikut dhe për këtë është e domosdoshme që të përmirësohet vazhdimisht niveli ekzistues i kulturës së transparencës parlamentare. Duhet të zhvillohet politika e transparencës me përcjelljen e trendëve informative dhe komunikuese, shfrytëzimin e teknologjive të reja dhe publikimin e të dhënave në format të lexueshëm nga makina. Kjo është e mbështetur edhe me të dhënat që tregojnë se parlamentet rajonale nuk janë të përkushtuara në publikimin e të dhënave të tyre në format të hapur dhe me këtë shfrytëzimi i vlerës së të dhënave të publikuara është minimizuar.

Transparenca e pamjaftueshme e seancave ende paraqitet si problem

Hulumtimi ynë tregon se parlamentet kryesisht nuk janë transparente kur bëhet fjalë për publikimin e të dhënave edhe nga seancat plenare edhe nga ato të komisioneve. Shumica e parlamenteve nuk publikojnë të dhëna nga votimet dhe listat e deputetëve që kanë marrë pjesë në seancat e komisioneve. Krahas kësaj, megjithëse shumica e vendeve i transmetojnë seancat publike edhe në publik (qoftë përmes transmetimeve të drejtpërdrejta ose transmetimeve tjera), seancat e komisioneve, dokumentet e tyre, votimet, etj. nuk janë transparente. Transkriptimet e plenumit dhe mbledhjeve të komisioneve janë gjithashtu informata që shpesh nuk janë të arritshme në ueb faqet e institucioneve.

Zhvillimi i pamjaftueshëm i komunikimit me qytetarët dhe mundësia për pjesëmarrjen e tyre

Parlamentet rajonale duhet ta forcojnë funksionin e tyre përfaqësues përmes krijimit të komunikimit me qytetarët dhe përfshirjes së tyre në procesin e krijimit të politikave. Parlamentet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zhvillimit të shërbimeve elektronike. Parlamentet duhet të jenë të arritshëm për qytetarët dhe përveç mundësisë për komunikim me telefon ose postë elektronike, domosdo duhet të iniciohen kanale novatore për komunikim të dyanshëm me qytetarët. Nevojitet edhe shfrytëzim më aktiv i mekanizmave ekzistuese të komunikimit, veçanërisht në rrjetet sociale. Hulumtimi tregoi se disa parlamente nuk kanë profile në rrjetet sociale ose nuk i shfrytëzojnë në mënyrë aktive (veçanërisht parlamentet e Bosnjës dhe Hercegovinës).

Mekanizmi i peticioneve elektronike nuk është i krijuar në asnjë prej vendeve në rajon, përveç në Mal të Zi, edhe pse dhoma ligjvënëse në këtë mënyrë mund të përfshijë qytetarë më aktivë në punën e kësaj dege të pushtetit. Gjithashtu, duhet doemos të theksohet se në Bosnjë dhe Hercegovinë ende nuk janë të rregulluar lobuesit dhe aktivitetet lobuese, megjithëse kjo është një temë e rëndësishme e cila duhet të shtjellohet.

Sigurimi i transparencës dhe përforcimit të praktikave antikorruptuese

Pa marrë parasysh kornizën e tanishme ligjore, parlamentet duhet të përpiqen ta rrisin transparencën e tyre. Partneriteti i pushtetit të hapur, në të cilën marrin pjesë kryesisht institucione të shkëlqyeshme, e përshëndet përfshirjen e niveleve dhe llojeve të ndryshme të institucioneve. Në rajon, kur bëhet fjalë për dhomat ligjvënëse, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i vetmi që është i përfshirë në këtë iniciativë. Parlamentet duhet t'i publikojnë edhe listat e plota të punonjësve, si dhe pagat e funksionarëve, zëvendësve dhe pagat e funksionarëve të zgjedhur. Shumica e parlamenteve të rajonit nuk kanë publikuar në ueb faqet e tyre, plane aktive për integritet, e as që kanë raporte shoqëruese për realizimin e tyre.

Patjetër duhet të përforcohet mekanizmi i kontrollit parlamentar

Hulumtimi konstatoi se në vendet e rajonit janë krijuar një sërë mekanizmash për kontroll parlamentar të pushtetit ekzekutiv. Mekanizmat si aktivitetet (dëgjimet) mbikëqyrëse nuk ekzistojnë në praktikë, ndërsa implementimi i tyre zakonisht ka karakter formal. Në praktikë mungojnë efekte të dukshme të kontrollit dhe për këtë shembujt që japin rezultate konkrete, në lidhje me përkufizimin e përgjegjësisë dhe sanksioneve për përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv ose degëve të tjera të pushtetit, janë shumë të rralla. Të gjitha parlamentet rajonale janë të obliguar që të ndër marrin masa për zbatimin e plotë të mekanizmave ekzistuese dhe me këtë të kontribuojnë për rritjen e niveleve të përgjegjësisë politike.

3.2. TRANSPARENCA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2021, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut punoi me protokolle të posaçme për shkak të pandemisë me Covid-19, që u implementuan edhe gjatë vitit 2020. Kuvendi edhe më tutje punoi në kushte të koordinimit të vështirësuar ndërmjet grupeve parlamentare dhe në mungesë të vullnetit nga ana e opozitës për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit. Me ndryshimet e rregullores, mes tjerash do të mundësohet edhe pjesëmarrja e deputetëve në seancat dhe votime në largësi, respektivisht pa prezencë fizike. Kundrejt qëndrimeve të një pjese të deputetëve, zakonisht nga opozita, mbi dy e treta e qytetarëve e përkrahin punën online të Kuvendit, por 37% e tyre konsideronin se online duhet të punojnë vetëm deputetët që janë pozitiv ndaj Covid-19 ose që janë në vetizolim¹³.

Kuvendi nuk kishte mbledhje gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale që u mbajtën në tetor të vitit 2021. Rezultatet e zgjedhjeve lokale ndikuan edhe në punën e Kuvendit. Partia me shumicë, Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), u ballafaqua me rënie të madhe në zgjedhjet lokale¹⁴, që ishte edhe arsye që ish-kryeministri Zoran Zaev të japë dorëheqje nga pozita e Kryeministrit. Dorëheqja e paralajmëruar më 31 tetor u dorëzua në Kuvend pothuajse dy muaj më vonë, më 22 dhjetor të vitit 2021, që la hapësirë për tentime të opozitës për të votuar mosbesim ndaj qeverisë së kryeministrit Zaev. Kërkesa e votimit të mosbesimit u parashtrua nga 70 deputetë, ndërsa në seancën e caktuar më datë 11 nëntor nuk u votua mosbesimi për shkak të mospasjes së kuorumit dhe tërheqjes së 10 deputetëve nga kërkesa e parashtruar e votimit të mosbesimit¹⁵.

Edhe përkundër këtyre rrethanave, Kuvendi e përmirësoi dukshëm efikasitetin e vetë gjatë vitit të dytë të pandemisë dhe e përmirësoi transparencën e vet sipas shkallës së transparencës për 3,74% duke realizuar rezultat të përgjithshëm prej 71,89%. Krahasuar me rajonin, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut është në vendin e dytë, menjëherë pas Kuvendit të Malit të Zi, që përmbush rreth 85,45% të indeksit të transparencës. Në vendin e tretë është pushteti ligjvënës i Bosnjës dhe Hercegovinës me 46,25 transparencë dhe në vendin e katër janë autoritetet ligjvënëse të Republikës së Serbisë që plotësojnë 43,04% të indeksit të transparencës.

Gjatë vitit të parë të pandemisë (2020) përbërja parlamentare ka përkushtuar 45 ditë pune për seancat plenare, ndërsa 77 ditë pune u janë dedikuar sesioneve plenare gjatë vitit 2021. Deputetët kanë debatuar për 376 propozim-ligje, ndërsa kanë miratuar 213 ligje. Rreth një e treta ose 81 ligje janë miratuar me procedurë të shkurtuar. Përdorimi i procedurës së shkurtuar edhe më tutje has në kritika, sepse e zvogëlon mundësinë për konsultime dhe për debate në Kuvend¹⁶. Në këtë drejtim, konstruktivitet më i madh

13 Të dhënat e anketës së terrenit për perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, të cilën Instituti i Demokracisë "Societas Civilis" e ka realizuar në periudhën nga 17 shkurti e deri më 10 mars 2020. Shkarkuar: <https://cutt.ly/4KKOhlk>

14 Numri i vendeve të kryetarëve të komunave që udhëhiqen nga LSDM-ja është ulur nga 57 në 16, ndërsa numri i komunave në të cilat ishin zgjedhur kryetarë të komunave nga radhët e VMRO-DPMNE-së është rritur nga 5 në 43. LSDM-ja e humbi betejën edhe në kryeqytetin e Shkup. Te partia më e madhe shqiptare BDI-ja, që është pjesë e koalicionit qeveritar, ndryshimet nuk janë të konsiderueshme, por e kanë humbur pozitën e kryetarit të komunës në Tetovë.

15 Votimi i besimit: opozitës i mungoi një votë për kuorum, Dojçe Vele. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/aKKOzLU>

16 Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut në vitin. Sekretariati për Çështje Evropiane. E marrë nga: <https://cutt.ly/SKKZ18g>

duhet të tregohet edhe nga opozita, përmes pjesëmarrjes së koordinuar dhe produktive në punën e Kuvendit, në vend që të zvarritet procesi i miratimit të ligjeve (filibustering).

Edhe krahas përmirësimit të konsiderueshëm të aktiviteteve të Kuvendit, propozim-ligje të caktuara që kanë rëndësi për zbatimin e Strategjisë për reforma të gjyqësorit 2018-2020 aspak nuk janë shqyrtuar nga ana e përbërjes së Kuvendit¹⁷. Trupat e kuvendit kanë mbajtur 246 seanca dhe kanë organizuar 7 debate publike për propozim ligjet¹⁸, që paraqet një progres në krahasim me vitin 2021¹⁹. Nuk është mbajtur asnjë debat mbikëqyrës gjatë vitit 2021, me çka funksioni mbikëqyrës i kuvendit është pozicionuar në pyetjet e deputetëve për të cilët janë mbajtur 8 seanca gjatë vitit. Deputetët më së shpeshti pyetjet e tyre i kanë parashtruar për kryeministrin, ndërsa temat më të zakonshme kanë qenë korrupsioni, pandemia me Covid-19, sundimi i së drejtës dhe sistemi gjyqësor²⁰.

Në vitin 2021 Kuvendi punoi edhe në ueb faqen e re e cila u lëshua në përdorim në vitin 2022. Ueb faqja e re në tërësi është më mirë e organizuar dhe për herë të parë përfshin pjesë të posaçme në lidhje me transparencën e Kuvendit. Në pjesën e Kuvendit transparent janë publikuar informata dhe dokumente në lidhje me buxhetin, prokurimet publike, llogaritë përfundimtare dhe raportet e revizionit, raporti final, informata për zyrat për kontakt me qytetarët.

Kuvendi gjithashtu e miratoi edhe planin e dytë të veprimit për Partneritetin e qeverisë së hapur 2021 – 2023²¹ dhe për herë të parë janë bashkëngjitur si anëtar i Këshillit për koordinim dhe implementim të planit të veprimit 2021-2023 në kuadër të iniciativës për transparencë të autoriteteve. Këshilli është një trup i përzier i përbërë nga 16 anëtarë, të përfaqësuar barazisht sipas institucioneve dhe organizatave qytetare.

3.2.1 Transparenca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kuvendi publikon pjesën më të madhe të informatave në lidhje me strukturën e tij organizative. Kështu, ueb faqja përmban informata dhe biografi për kryetarin, nënkryetarët, deputetët dhe sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit. Është publikuar organogrami, lista e të punësuarve në kuadër të sektorëve, si dhe kontaktet e tyre. Në këtë korpus të informatave, Kuvendi duhet t'i publikojë edhe pagat e funksionarëve, që paraqet një rekomandim disavjeçar në kuadër të këtij raporti.

17 Kjo para se gjithash ka të bëjë me pakon e propozim-planeve që Qeveria i miratoi në seancën e 92 më datë 27.7.2021, e që Kuvendi deri më sot nuk i ka shqyrtuar në seancë. (Ligji për procedurë kontestimore, Ligji për avokaturë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, Ligji për kompensim në para të viktimave nga veprat penale të kryera me dhunë, Ligji për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë).

Raporti për implementimin e Strategjisë për reforma në gjyqësi 2018-2021, për vitin 2021. Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/xKKXOXf>

18 Raporti vjetor i Kuvendit për vitin 2021. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://www.sobranie.mk/godishen-izveshtaj.nspj>

19 Vlerësimi i sundimit të mirë në Maqedoninë e Veriut dhe rajon përmes indeksit të transparencës, Kuvendi dhe pushteti ekzekutiv. Në momentin e shënimit të raportit nuk kemi raport vjetor të Kuvendit për 2020. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/WKKPrWi>

20 Pyetje të deputetëve: sa kanë argumentuar deputetët dhe çfarë kanë pyetur më së shumti? (janar-dhjetor 2021. E marrë nga: <https://cutt.ly/UKKPu40>

21 Plani i veprimit për Partneritetin e Qeverisë së Hapur për vitin 2021-2023 të Kuvendit të RMV-së. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://www.sobranie.mk/akciski-plan-pov.nspj>

Kuvendi i publikon aktet kryesore juridike si dhe dokumentet e brendshme prej të cilave buron mandati dhe mënyra e punës. Janë publikuar Kushtetuta, Rregullorja e punës, Plani strategjik për vitet 2021-2023, si dhe një set me akte të miratuara nga Sekretari i përgjithshëm, e që kanë rëndësi për punën e Kuvendit²².

Megjithatë Kuvendi edhe më tej nuk e ka publikuar Strategjinë për transparencë ose strategjinë komunikuese me të cilën do të përmirësohet transparenca e tij, e me këtë edhe besimi i qytetarëve dhe arritshmëria e tyre.

Kuvendi edhe më tutje e zbaton praktikën e mirë të publikimit të materialeve dhe informatave në lidhje me procesin e miratimit të ligjeve. Publikohen propozim-ligjet, shënimet stenografike të diskutimeve, amendamentet, mënyra e votimit si dhe video materialet e seancave. Gjithashtu, si praktikë e mirë është edhe fakti që materialet në lidhje me procesin e miratimit të ligjeve në masë të madhe publikohen në format të hapur. Megjithatë, përmirësimi i praktikës është i nevojshëm kur bëhet fjalë për materialet që publikohen për trupat e Kuvendit, respektivisht të publikohen rregullisht shënimet stenografike, informatat për mënyrën e votimit, video materialet e seancave dhe mendimet e ekspertëve të dhëna si pjesë e debateve publike, të organizuara përmes komisioneve të Kuvendit.

Kuvendi publikon raport të detajuar vjetor, që përmban raportin e punës së trupave të Kuvendit, por ky raport edhe më tutje nuk reflekton planet ose programet e punës së Kuvendit. Edhe krahas sugjerimeve të shumta dhe të vazhdueshme, si në këtë po ashtu edhe në raportet e tjera, Kuvendi patjetër duhet të miratojë plan dhe program vjetor të punës. Me miratimin e Planit dhe programit vjetor të punës, Kuvendi do ta përmirësojë parashikueshmërinë e punës së Kuvendit dhe do të rritet kualiteti i konsultimeve publike në Kuvend. Përmes planeve dhe programeve të miratuara të punës, gjithashtu do të nxitet koordinim më i mirë ndërmjet partive politike dhe do të mund të kontribuohet për një rol më konstruktiv të opozitës, që shpeshherë akuzohet se miraton ad hock ligje ose politika, andaj për këtë arsye bëhet edhe keqpërdorim i mekanizimit të procedurës së shkurtuar dhe miratimit të ligjeve me flamur të BE-së²³.

Krahas raportit vjetor, Kuvendi publikon edhe raporte gjysmëvjetore Deputeti im, por publikimi i tyre nuk është i rregullt, andaj zakonisht është në dispozicion vetëm njëri raport gjashtëmujor gjatë një viti kalendarik²⁴. Publikimi i raportit Deputeti im ka rëndësi të veçantë sepse përmes tyre ndiqet angazhimi dhe aktiviteti i secilit deputet në punën e Kuvendit.

3.2.2 Të dhënat e hapura

41,88% e informatave dhe materialeve që janë në dispozicion në ueb faqen e Kuvendit janë të arritshme në format të hapur. Me miratimin e Planit të Veprimit të Kuvendit për 2021-2023 si pjesë e iniciativës së Partneritetit për pushtet të hapur, Kuvendi u obligua për përpilimin e platformës on-line për të dhëna të hapura me çka do të përmirësohet qasja e qytetarëve në informatat. Kjo përpjekje parasheh krijimin e një mjeti softuerik që

22 Aktet – Sekretari i Përgjithshëm. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/zKKPFNM>

23 Flamuri evropian e aktivizon makinerinë votuese të deputetëve. Evropa e Lirë. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/9KKPSuM>

24 Deputeti im. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://www.sobranie.mk/mojot-pratenik.nspix>

do të mundësojë: hapjen e seteve me të dhëna në formate të lexueshme kompjuterike; prodhimin e seteve me të dhëna gjatë punës së përditshme të Kuvendit; publikimin e meta të dhënave për setet me të dhëna; dhe rritjen e përfshirjes së shfrytëzuesit përmes ripërdorimit të të dhënave (re-usage).

3.2.3 Transparenca financiare

Në momentin që shkruhet ky raport, tanimë është lëshuar në përdorim ueb faqja e re e Kuvendit, ku për herë të parë ekziston një pjesë e posaçme për transparencën financiare, me çka në njëfarë mënyre, janë pranuar vërejtjet e këtij raporti nga vitet e kaluara. Ueb seksioni i dedikuar për transparencën financiare përfshin informata për buxhetin, prokurimet publike, llogaritë përfundimtare dhe raportet e revizionit. Rekomandojmë që kjo pjesë të përmbajë edhe link direkt deri te Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit që do të çojë deri te aktzotërimet e deputetëve. Si lëvizje pozitive është edhe fakti që informatat për shkallën e shfrytëzimit të buxhetit publikohen në nivel mujor, ku shënohen edhe informatat për shpenzimet e transportit dhe shpenzimet ditore të deputetëve, që ka rëndësi të posaçme nëse merren parasysh skandalet e shumta për shumtë e larta që deputetët i kanë shpenzuar nga buxheti i kuvendit²⁵. Por këto të dhëna duhet të jenë në format të hapur për ta lehtësuar analizën e tyre. Në aspekt të buxhetit, mbetet rekomandimi që Kuvendi të publikojë buxhetin qytetar dhe të përmirësojë konsultimet gjatë miratimit të tij.

Kuvendi i përmbushi nivelin e lartë prej 93,3% të indikatorëve kushtuar prokurimeve publike. Në vitet e fundit, Kuvendi ka shënuar rritjen më të madhe të transparencës, pikërisht në pjesën e prokurimeve publike. Në ueb faqen e re janë të shënuara të gjitha aspektet e rëndësishme për ndjekjen në kohë të prokurimeve publike: prokurimet e planifikuara, publikimi i shpalljeve, kontratat e lidhura dhe të realizuara si dhe vendimet e miratuara. Kuvendi duhet ta përmirësojë praktikën e vet përmes publikimit të raporteve vjetore për prokurimet publike.

3.2.4 Qasja në informatat me karakter publik

Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik, me ndryshimet e vitit 2019 e zgjeroi dhe saktësoi listën e informatave që poseduesit e informatave siç është Kuvendi, duhet në mënyrë proaktive t'i publikojnë në ueb faqen e tyre. Për të pasur kërkesit pasqyrë më të mirë, poseduesit duhet që në ueb faqet e tyre, në një vend, ta publikojnë tërë listën e informatave dhe dokumenteve që e konsiderojnë si informatë me karakter publik, në pajtim me ligjin.

Kuvendi edhe më tutje nuk ka publikuar kontaktin e personit të caktuar për të drejtën e qytetarëve për të realizuar qasje në informatat me karakter publik. Madje edhe ueb faqja e re, në pjesën e Kuvendit transparent, nuk përfshin pjesën e posaçme të dedikuar për qasje në informatat. Aty duhet të vendoset lista e plotë e informatave dhe dokumenteve

25 „193.000 euro për shpenzime të udhëtimit janë paguar për deputetët gjatë 9 muajve „kalo kartelën – ik!“, Dua të them. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/NKKPBZh>

të cilat Kuvendi i përcakton si informata me karakter publik, linku deri te këto informata, publikimi i informatave të kërkuara dhe të miratuara, si dhe raporti vjetor për zbatimin e ligjit. Ueb faqja nuk përmban informata për procedurën në të cilën realizohet ose mbrohet kjo e drejtë, ndërsa sipas informatave të marra përmes pyetësorit që për këtë hulumtim e dorëzoi Kuvendi, shërbimet gjatë vitit 2021 nuk kanë ndjekur trajnime për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

3.2.5 Konsultimet publike

Parakusht për konsultime kualitative është ekzistimi i programit vjetor dhe kalendarit të aktiviteteve, veçanërisht për funksionin ligjvënës të Kuvendit, si dhe të ekzistojnë rregulla të qarta për mënyrën se si duhet të realizohen konsultimet publike. Në rastin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, nuk janë plotësuar këto kushte minimale për konsultime përmes të cilave qytetarët do të mund të marrin pjesë në procesin e krijimit të ligjeve. Me ekzistimin e kalendarit, palët e interesuara do të mund të përgatiten për pjesëmarrje në konsultime kur procedurat e qarta do të mundësojnë një detyrim për konsultime, e jo si përjashtime, siç edhe bëhet në praktikë në Kuvendin e RMV-së. Për momentin, kalendari që është në dispozicion në faqen e Kuvendit, përmban vetëm informata për aktivitetet mujore. Për nevojën e parashikueshmërisë së procesit të miratimit të ligjeve, ka sugjeruar edhe Komisioni Evropian në raportin e fundit të tyre për vitin 2021.

Dispozita e Rregullores sipas së cilës ekziston mundësi që ekspertët dhe përfaqësuesit e organizatave qytetare të marrin pjesë në punën e komisioneve të kuvendit²⁶, nuk paraqet garanci për proceset konsultative. Procedura e brendshme e konsultimeve duhet të përcaktojë: kur duhet të zbatohen konsultimet; si të njoftohen konsultimet dhe kush ftohet të marrë pjesë; futjen e një regjistri të palëve të interesuara; afatet për dorëzimin e mendimeve dhe publikimi i tyre, si dhe raporti i obligueshëm për konsultimet e realizuara.

3.2.6 Bashkëveprimi me qytetarët

Kuvendi duhet ta përmirësojë komunikimin me qytetarët dhe ta rrisë besimin ndaj këtij institucioni. Sipas hulumtimeve në terren, të bëra nga Instituti Ndërkombëtar Republikan, në një ekzemplar reprezentativ të realizuar në nëntor dhe dhjetor të vitit 2021, vetëm 3% e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut, kanë besim në këtë institucion. Kuvendit i besojnë deri diku rreth 27%, ndërsa 33% në masë të madhe nuk i besojnë²⁷. Kur bëhet fjalë për gatishmërinë e Kuvendit për përfshirjen e publikut në punën e vet, më shumë se gjysma e të anketuarve në vitin 2021 (55%) konsiderojnë se Kuvendi është tërësisht ose pjesërisht i mbyllur për publikun, që është për 6 pikë të përqindjes më tepër, krahasuar me vitin 2020²⁸.

26 Rregullorja e Kuvendit të RMV-së, neni 122, paragrafi 2. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/kKKP63j>

27 Hulumtimi i mendimit publik, Maqedonia e Veriut, slajd 16. E marrë nga: https://www.iri.org/wp-content/uploads/2022/03/IRI-N-Macedonia_Nov-December-2021-Poll.pdf

28 Transparenca e Kuvendit: Informimi dhe përfshirja e publikut në punën e deputetëve. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/jKKAi2E>

Deputetët janë të obliguar për secilën ditë të fundit të javës të jenë në kontakt me elektoratin e tyre, përmes pranisë fizike dhe qasjes në njësinë e vetëqeverisjes lokale nga e cila ato janë zgjedhur në funksionin e deputetit. Në dispozicion janë edhe informatat për kontaktet dhe lokacionet e zyrave lokale për kontakt me qytetarë, por nuk ekziston raport kualitativ ose kuantitativ për efektet e këtyre takimeve. Raporti Deputeti im duhet të përmbajë edhe informatë për numrin e takimeve që i ka pasur deputeti përmes zyrave për kontakt me qytetarët, pyetjet që i kanë parashtruar qytetarët dhe nëse është ndërmarrë aktivitet lidhur me shqetësimin për të cilin qytetarët i janë drejtuar deputetit të tyre.

Nga ana tjetër, Kuvendi ofron mundësi të shkëlqyeshme që qytetarët të njihen me punën e tij, në mënyrë virtuale përmes materialeve dhe tutorialeve në dispozicion ose përmes vizitës fizike të Kuvendit për të cilën qytetarët duhet të paraqiten në kohë. Instituti parlamentar ofron informata të mira për kompetencat dhe funksionet e Kuvendit dhe jep një retrospektiv të mirë për ngjarjet historike dhe konsultative që kanë rëndësi për Kuvendin. Megjithatë, është mirë që materialet që janë vetëm në format audio, të përfshijnë edhe titra dhe video me gjuhën e shenjave.

Qytetarët edhe më tutje mund të kontaktojnë drejtpërdrejt me deputetin e tyre, Kryetarin Kuvendit ose shërbimet, po nuk ekziston mundësi për peticion elektronik të institutit, në të cilën detyrimisht duhet të jepet përgjigje nga Kuvendi, në formë dhe procedurë të përcaktuar. Plani i veprimit të Kuvendit për 2021-2023 si pjesë e iniciativës të Partneritetit për pushtet të hapur, parashih platformë për propozime dhe iniciativa të qytetarëve dhe regjistër të organizatave qytetare. Ky aktivitet duhet të realizohet deri në fund të dhjetorit të vitit 2022.

3.2.7 Integriteti

Kuvendi disponon me mekanizmat formale për garantim të integritetit dhe parandalim të korrupsionit. Në dispozicion është Kodi për sjellje etike të deputetëve dhe aktzotërimet përmes Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Nga qershori i vitit 2021 fillon edhe zbatimi i Ligjit për lobim, që ofron përfshirje të gjerë të funksionarëve edhe për procedurat e miratimit të vendimit dhe politikave ndaj të cilave mund të ndikojnë lobuesit dhe për të cilat duhet të njoftojnë. Institucioni kompetent për ndjekjen e aktiviteteve për lobim nuk është më në Kuvend por në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Kodi Etik nuk ofron instrumente për ndjekjen e zbatimit të tij, por përcakton procedurë për konstatimin e shkeljeve të lehta dhe të rënda të Kodit dhe për shqiptimin e masave²⁹. Megjithatë, pas mbylljes së mbledhjes së të dhënave për këtë raport, në qershor të vitit 2022, u vu në test zbatimi i kodit etik, kur deputetët e opozitës kërkuan që të caktohet seancë³⁰ në të cilën do të shqyrtohet nëse Kryetari i Kuvendit e ka shkelur kodin etik, kur verbalisht i ka sulmuar dhe ofenduar nëpunësit e kuvendit, për çka edhe kishte materiale të qarta audio të arritshëm për publikun. Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit

29 Rregullat për udhëheqjen e procedurës për konstatimin e shkeljeve të rënda dhe të lehta dhe shqiptimin e masave të përcaktuara me Kodin për sjellje etike të deputetëve. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/9KKAgtV>

30 Detajet për seancat e komisionit. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. E marrë nga: <https://cutt.ly/WKKCaRR>

dhe Imunitetit nuk e miratoi rendin e ditës³¹, me çka aspak nuk u hap debat në këtë temë. Komisioni duhej të sigurojë debat, pa marrë parasysh motivet potenciale politike, për të mundësuar debat për zbatimin e kodit etik.

Trajnimi për zbatimin e kodit etik për deputetët, përfshirë edhe konfliktin e interesave dhe parandalimin e korrupsionit, të realizuar nga të punësuarit e Institutit Parlamentar, në seksionin për edukim dhe komunikim, me qëllim të përfshirjes në kurrikulën e trajnimeve për deputetët si dhe për seancat hyrëse për deputetët. Trajnimi është organizuar në dhjetor të vitit 2021 nga ana e organizatës qytetare Qendra për Menaxhim me Ndryshime.

3.2.8 Monitorimi, vlerësimi dhe planifikimi strategjik

Kuvendi përmbush 73,3% të treguesve për monitorim, vlerësim dhe planifikim strategjik. Megjithatë, për të pasur rezultate të mira, rekomandohet që Kuvendi t'i qaset përcaktimit të procedurës personale për konsultime, që do të përfshijë edhe procedurën e vlerësimit të ndikimit të rregullativës, si dhe procedurën për përfshirjen e ekspertëve në punën e trupave të Kuvendit. Me rëndësi të madhe për funksionin mbikëqyrës, është që në tërësi të publikohen përgjigjet e ministrave, të dhëna në aspekt të pyetjeve të deputetëve, si për ato që janë siguruar gojarisht në vetë seancën, ashtu edhe për ato që sigurohen me shkrim nga seancat e pyetjeve të deputetëve. Gjithashtu, edhe këtë vit përsëritet rekomandimi për shqyrtimin e të gjitha raporteve që i publikon dhe dorëzon Enti Shtetëror i Revizionit në trupat adekuate të Kuvendit dhe të miratohen konkluzionet përkatëse. Formalisht por edhe në praktikë, Komisioni Juridik-Ligjvënës është i ngarkuar dukshëm lidhur me trupat tjerë të punës, andaj praktika e tillë e mandatit ë zgjatur duhet të pranohet edhe nga Komisioni për Financim dhe Buxhet, por edhe komisionet tjera të cilëve u referohen materialisht raportet të cilat i shqyrton Enti Shtetëror i Revizionit.

3.2.9 Plan gjithëpërfshirës për qeverisjen e mirë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kemi përgatitur sërë rekomandimesh që janë ndarë në bazë të katër kategorive që i përpunam më lartë. Këto rekomandime i adresojnë edhe problemet e lartpërmendura dhe duhet të shërbejnë si plan gjithëpërfshirës për qeverisjen e mirë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

31 Kodi Etik për Talat Xhaferin. TV24. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/5KKAz8U>

Transparenca

- Kuvendi duhet të miratojë dokument intern për strategjinë komunikuese të Kuvendit (PR). Gjithashtu, Kuvendi duhet të miratojë dhe të publikojë politikën e transparencës, që mes tjerash, do ta përmirësojë perceptimin e publikut dhe do të jetë më e arritshme për qytetarët dhe palët e interesuara.
- Kuvendi duhet të krijojë dhe rregullisht të publikojë programin vjetor të punës dhe sipas saj të publikohet në kalendarin preliminar për aktivitetet e tyre.
- Kuvendi duhet të publikojë një listë të strukturuar të deputetëve me kontaktet e tyre në format të hapur.
- Kuvendi duhet t'i publikoj pagat e deputetëve dhe të sekretarit të përgjithshëm.
- Kuvendi duhet t'i publikoj videot dhe të gjitha dokumentet që dalin nga mbledhjet e komisioneve, në ueb faqen e tyre.
- Kuvendi duhet t'i publikojë shënimet e votimeve të komisioneve.
- Kuvendi duhet t'i publikojë mendimet e ekspertëve të prononcuar si pjesë e konsultimeve dhe së bashku me propozim-ligjet, të publikohen edhe mendimet e dhëna të trupave ndërkombëtare (p.sh, Komisionit të Venecias).
- Kuvendi duhet ta publikojë edhe Buxhetin e qytetarëve në ueb faqe.
- Kuvendi duhet të publikoj linkun deri te ueb faqja e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, ku publikohen edhe aktzotërimet e deputetëve.
- Kuvendi duhet t'i publikojë anekset e marrëveshjeve dhe raporteve vjetore për prokurime publike.
- Të gjitha komisionet në kuadër të Kuvendit, duhet ta shqyrtojnë propozimin e buxhetit shtetëror.

Qasshmëria

- Kuvendi duhet të publikojë në ueb faqen e vet, informatat kontaktuese të personit zyrtar të ngarkuar për qasje të lirë në informatat me karakter publik, sqarimi i procedurës për marrjen e informatës me karakter publik, por edhe t'i publikojë informatat për të cilat tanimë është miratuar qasje e lirë.
- Kuvendi duhet të miratojë akt të brendshëm për proceset konsultative. Deri në miratimin e një akti të tillë, komisionet duhet të bashkëpunojnë dhe të kërkojnë komente/mendime nga publiku, zakonisht përmes hapjes së thirrjeve publike për komente dhe propozime të publikut.
- Nëpunësve shtetërorë duhet t'u mundësohen trajnime për ndërtimin e kapaciteteve në sferën e qasjes në informatat me karakter publik, por edhe

të dhëna të hapura, si dhe udhëzime se si të shfrytëzohen dhe publikohen të dhënat e hapura.

- Ueb faqja e Kuvendit duhet të plotësohet me material edukativ, në të cilin do të shfrytëzohen edhe titrat ose gjuha e shenjave.
- Kuvendi duhet të theksojë kufizimet e praktikës së miratimit të ligjeve në procedurë të shkurtuar, vetëm në kushte të parapara.
- Kuvendi duhet të publikojë në ueb faqen e vet, udhëzimet për parashtrimin e ankesave dhe reagimeve, si dhe të krijojë një kanal të posaçëm për peticion elektronik.
- Kuvendi duhet t'i zbatojë në kohë dhe tërësisht obligimet e Planit të veprimit të Kuvendit 2021-2023, si pjesë e iniciativës Partneriteti për pushtet të hapur, si dhe ta zgjerojë numrin e organizatave qytetare që janë të inkuadruar në implementimin e obligimeve.

Integriteti

- Kodi i sjelljes etike të deputetëve duhet ta rregullojë edhe aktivitetin politik të deputetëve.
- Kuvendi duhet të krijojë mekanizma koncize për ndjekjen e zbatimit të Kodit për sjellje etike të deputetëve.
- Kuvendi, në ueb faqen e vet duhet të publikojë informata për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Kuvendi duhet të miratojë dhe publikojë planin e integritetit ose format tjetër të politikës së brendshme për luftimin e korrupsionit, që përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike brenda institucionit.

Efikasiteti

- Kuvendi duhet të fillojë me praktikën e vlerësimit strategjik të ndikimeve potenciale të akteve juridike ekzistuese dhe të përgatitura.
- Duhet të ketë sanksione për ministrat dhe funksionarët e tjerë ekzekutivë për mospjesëmarrje në seancat dëgjimore.
- Kuvendi duhet t'i shqyrtojë të gjitha raportet e revizionit që i përgatit Enti Shtetëror i Revizionit.

4. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

4.1. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON

Më e hapur është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, që përmbush 82,71% të kriterëve të vendosura për transparencë, pas së cilës vijon Qeveria e Malit të Zi me 58,16%. Në vendin e tretë është BdheH me 49,58%. Qeveria e Republikës së Serbisë është në vendin e fundit me përmbushje 37,96% të kriterëve për transparencë.

Transparenca e autoriteteve është njëra prej çështjeve kryesore të reformës së administratës publike dhe procesit të integritetit evropian që e udhëheqin vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithëse rajoni ynë formalisht punon në këto detyra të cilat duhet të na afrojnë në familjen evropiane, prapë se prapë ekziston një përdorim i fortë i rregullimit sistematik të politikave të transparencës dhe komunikimit, që patjetër duhet të pozicionohen në bazë afatgjate për të pasur përfitime konkrete dhe të përhershme për komunitetet tona dhe për shoqërinë. Çështja e transparencës së shpenzimit publik potencohet si tejet e ndjeshme, ndërsa nevoja për përfshirjen e qytetarëve dhe sektorit qytetar në krijimin e politikave dhe vendimmarrjes meriton një apel.

Të dhënat e mbledhura përmes Indeksit të transparencës rajonale, tregojnë se aktivitetet e hapura dhe transparente të institucioneve ekzistojnë vetëm në nivel individual dhe se nuk janë vendosur praktikata afatgjate të sjelljes, respektivisht ka shembuj të rrallë të institucioneve që kanë krijuar rregulla dhe procedura të veprimit publik. Në veçanti na brengos fakti që në nivelin e transparencës ndikojnë ndryshimet kadrovike në nivel të institucionit, e jo të programeve dhe politikave të një vendi.

Për këtë arsye, ne vazhdimisht i thërrasim qeveritë e vendeve të rajonit që të punojnë në zhvillimin e strategjive dhe rregullativave për transparencë të pushtetit ekzekutiv, por që edhe në mënyrë aktive të përfshihen në iniciativat ndërkombëtare të orientuara ndaj promovimit të qeverisjes së mirë.

Të dhënat tregojnë se në vitin 2021, rezultate më të mira kanë arritur Qeveria e Maqedonisë së Veriut (82,71%), pastaj Këshilli Ministror i Bosnjës dhe Hercegovinës (75,54%), Qeveria e Malit të Zi (58,16%) dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (45,43%).

Më tutje, Qeveria e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës përmbush rreth 38,17% të treguesve për transparencë, Qeveria e Republikës Serbe 35,85% ndërsa qeveria krahinore e Vojvodinës me 30,49%.

Kur bëhet fjalë për ministritë, rezultate më të mira mesatarisht kanë arritur ministritë e Maqedonisë së Veriut me 58,56% përmbushje të treguesit të transparencës. Në vendet e tjera, ministritë përmbushin më pak se gjysmën e treguesve të vendosur – në Mal të Zi 48,17%, Serbi 46,82%, Bosnjë dhe Hercegovinë 38,5%.

Rezultate më të dobëta vërejmë te organet e administratës shtetërore. Organet në përbërje të Maqedonisë së Veriut, mesatarisht përmbushin 41,54%, Mali i Zi 40,82%, Bosnja dhe Hercegovina 40,49% dhe Serbia 31,20%.

Në vazhdim të këtij dokumenti tregojmë disa prej pikave kritike për arritjen e nivelit më të lartë të transparencës të autoriteteve ekzekutive në rajon.

(Qasja (Jo)strategjike e politikave të transparencës

Maqedonia e Veriut është vendi i parë i rajonit i cili vendosi që politikën e transparencës ta bëjë të veçantë përmes një strategjie të posaçme. Strategjia e transparencës së Qeverisë së Maqedonisë së Veriut ka për qëllim përmirësimin e transparencës dhe besimit në punën e institucioneve. Përvoja e këtij vendi, konfirmon se nuk mjafton vetëm planifikimi i mirë i aktiviteteve për të pasur transparencë më të madhe të autoriteteve. Esenciale është që të krijohet një sistem i monitorimit dhe vlerësimit bazik, me qëllim për të siguruar realizim kualitativ të aktiviteteve të planifikuara. Të dhënat e tona tregojnë se zbatimi i kësaj strategjie stagnon shpesh. Nga gjithsej 45 aktivitete të Plan veprimit strategjik, më shumë se gjysma aspak nuk janë realizuar. Vetëm nëntë aktivitete janë tërësisht të realizuara në afatin e paraparë, tri janë realizuar me vonesë, ndërsa tetë aktivitete janë në vijim e sipër.³² Qeveria e Maqedonisë së Veriut, nevojitet që ta vazhdojë periudhën e zbatimit të strategjisë, t'ua përshtatë atë kushteve të reja shoqërore-politike dhe të sigurojë mekanizma për realizim konsekuent të aktiviteteve të planifikuara.

Në vitin 2000, Bosnja dhe Hercegovina e fitoi Ligjin për qasje të lirë në informatat (SPI), i pari në nivel shtetëror, më pas në vitin 2001 edhe në të dy entitetet. Po, megjithëse ishte shteti i parë në rajon që e miratoi këtë ligj, deri më sot nuk ka kërkesa të konsiderueshme progresive për lehtësimin e qasjes në informata si dhe një transparencë më të madhe. Përveç kësaj, propozim-ligjet e reja janë shumë më të këqij se sa ligji i tanishëm. Drafti i parë i Ligjit për qasje të lirë në informata, që u publikua nga Ministria e Drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës në shkurt të vitit 2021, në mënyrë plotësuese e vështirëson qasjen në informatat. Në veçanti na shqetëson lista e gjatë e përjashtimeve ose kufizimeve të mundshme për qasje në informatat që i posedojnë organet publike, por edhe mundësia për vazhdimin e afatit të deritanishëm 15 ditor për veprim ndaj kërkesave për qasje të lirë, për edhe 15 ditë tjera. Është problematike edhe fakti që në draftin preliminar, mes tjerash, është theksuar se organ i shkallës së dytë në procedurat e realizimit të së drejtës për qasje në informatat, është Këshilli për Ankesa pranë Këshillit Ministror të Bosnjës dhe Hercegovinës, në vend të institucionit të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut të Bosnjës dhe Hercegovinës, si një institucion i pavarur i cili e ka ndjekur zbatimin e këtij ligji.

32 Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për transparencë (2019-2021) në periudhën nëntor 2019 – nëntor 2021. Fondacioni Metamorfozis. E marrë nga: <https://cutt.ly/yKXsW4f>

Ndryshimet e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik në Serbi u miratuan në nëntor të vitit 2021, pas më shumë se pesë viteve punë për këtë akt. Organizatat që morën pjesë në procesin e konsultimit publik konsiderojnë se teksti i miratuar mund që vetëm pjesërisht t'i zgjidhë problemet për implementimin e ligjit. Vërejtjet kryesore janë se problemi me mosrealizimin e vendimit të miratuar nga Komisari për informata të karakterit publik, nuk është e adresuar në mënyrën e duhur, si dhe me ndryshimet nuk adresohet si duhet nevoja për transparencë proaktive të organeve publike. Sektori qytetar u përpoq që të imponojë disa zgjidhje më progresive përmes Ligjit, që do t'u mundësojnë qytetarëve të dinë më shumë për atë se si i shpenzojnë institucionet paratë publike dhe se si menaxhojnë me resurset publike dhe autorizimet. Por, për shkak të zgjidhjeve jo të mira me propozim-ligjet e para, ky proces u shndërrua në mbrojtje të drejtave të realizuara. Pikërisht për këtë arsye, konstatimi i organizatave të përfshira në këtë proces është se kemi lëshuar mundësinë që në mënyrë esenciale të përmirësohet rregullativa kryesore që e rregullon çështjen e publikut me punën e institucioneve.

Çështja e planifikimit strategjik të transparencës së punës së pushtetit ekzekutiv në Mal të Zi deri më tani nuk ishte ndër prioritetet e para qeveritare. Të gjitha tentimet e deritanishme që këto çështje të sistematizohen në një dokument, dështuan, ashtu që këto politika ende i presin elitat politike për të dhënë përkrahjen e nevojshme të procesit të këtillë dhe për të filluar hapat e reformimit. Mali i Zi nuk arriti rezultate të duhura përmes pjesëmarrjes në iniciativën e Partneritetit të hapur qeveritar. Pritet që qeveria e re ta rifillojë këtë proces dhe të miratojë një plan të ri të veprimit. Ligji i ri për qasje të lirë në informatat ende është në vijim e sipër. Me aktin e propozuar shtohen obligime të reja në sferën e publikimit proaktiv të informatave që i posedojnë organet publike. Megjithatë kjo do të thotë përparim, shtrohet pyetja se sa do të jenë të suksesshme këto norma ligjore, duke marrë parasysh se modeli i deritanishëm i ndjekjes së zbatimit të ligjit nuk bëri që të ketë proaktivitet më të madh të autoriteteve.

Ngjitja e etiketës „sekret“

Autoritetet shpeshherë i shfrytëzojnë autorizimet e tyre që t'i shpallin dokumentet dhe të dhënat si sekrete, ndërsa publiku për shkak të natyrës së informatave konfidenciale, e ka shumë të vështirë që të bëjë kontroll mbi sistemin për konfidencialitet. Publiku zakonisht nuk ka mënyrë që ta vejë në pikëpyetje klasifikimin e paarsyeshëm eventual të dokumenteve, e as që t'i ndjekë afatet për ndërprerjen e fshehtësisë së dokumenteve.

Të dhënat sipas Indeksit të transparencës tregojnë se ministrinë në territoret e këtyre katër vendeve nuk kanë praktikë të unifikuar dhe standarde të definuara, kur bëhet fjalë për dhënien e informatave për vëllimin e dokumenteve të shpallura me një shkallë të caktuar të sekretit.

Gjegjësisht, një pjesë e ministrive na i dorëzuan të dhënat e kërkuara statistikore për numrin e dokumenteve të shënuara me një shkallë të caktuar të sekretit, me çka konfirmuan se informata e kërkuar duhet të konsiderohet si informatë me interes dhe rëndësi publike. Nga ana tjetër, disa ministri refuzuan që t'i japin informatat e kërkuara me arsyetimin se edhe statistika për numrat e informatave të klasifikuara, paraqet informacion të klasifikuar. Gjithashtu, disa ministri deklaruan se nuk është e mundur që

të jepen informatat e klasifikuara sepse për atë duhet të përpilohet një dokument i ri, respektivisht se nuk mbajnë evidencë të tillë.

Ligjet parashohin se konfidencialiteti i të dhënave mund të jetë arsye për mosdhënien e informatave, por ajo nuk nënkupton se qasja në informatat e klasifikuara është tërësisht e pamundësuar. Ligjet parashohin mënyra të ndryshme të veprimit nëse kërkesa për qasje në informata ka të bëjë me informata të klasifikuara, por të gjithë kanë për qëllim që ta rishqyrtojnë vendimin për fshehtësi, respektivisht sugjerojnë se është e domosdoshme që në këtë rast të vlerësohet nëse ekziston interes që dominon mbi të drejtën për qasje në informata. Dallimet e legjislaturës tonë është në faktin se cili është organi që duhet ta shqyrtojë dhe sigurojë qasjen deri te të dhënat.

Statistika për numrin e dokumenteve të shënuara si sekrete vetëm se na jep një pasqyrë se sa ka qenë aktive një ministri e caktuar për fshehtësinë e të dhënave në nivel vjetor. Gjithashtu, duke u nisur nga fakti se publiku ka të drejtë që të bëjë kontroll në punën e organeve publike, ndërsa shënimi i dokumenteve si sekret është pjesë e autorizimeve që i kanë ministrinë, është i arsyeshëm edhe interesi i publikut që të dijë se si këto ministri i shfrytëzojnë këto autorizime.

Në shtojcë të kësaj se informata e kërkuar duhet të konsiderohet si informatë deri te e cila publiku ka të drejtë të qasjes, të flasë edhe fakti që pjesa më e madhe e ministrive ua kanë dhënë kërkesve këtë informatë. Nga ana tjetër, ministrinë që nuk e kanë bërë këtë, nuk kanë sqaruar se si qasja në informatat e kërkuara, mund të çojë në pasoja të rënda për interesat e mbrojtura me ligj që e rregullon sekretin dhe nëse është zbatuar procedura për rishqyrtim të vendimit për shënimin e dokumentit si sekret.

Vështirë për të arritur te informatat edhe përmes mekanizmave ligjore

Të dhënat e Indeksit të transparencës, tregojnë se informata të caktuara për punën e organeve qeveritare nuk mund të merren, madje edhe kur ligji i obligon për të dhënë informata për kërkesit.

Dy e treta e institucioneve në rajon, janë përgjigjur ndaj kërkesave tona për qasje të lirë në informata, brenda afatit ligjor. Prej tyre, 9,5% nuk kanë dhënë përgjigje, por pas skadimit të afatit ligjor prej 15 ose 20 ditëve në Maqedoninë e Veriut, ndërsa 24% nuk kanë dërguar përgjigje.

Si pjesë e këtij hulumtimi, kemi dërguar edhe pyetësor për institucionet mbikëqyrëse, edhe siç pritej, kur bëhet fjalë për bashkëpunim vullnetar me organizatat qytetare, vërehet një trend edhe më negativ.

Domethënë, duke parë këtë si një tregues për suksesin e bashkëpunimit me sektorin qytetar, e kur do të merren parasysh edhe të dhënat që i kanë dorëzuar më pak se gjysma e institucioneve, në kuadër të pyetësorit, është e qartë se ajo është edhe një arsye shtesë për t'u shqetësuar.

Proaktiviteti vetëm si shkronjë e vdekur në letër

Me përjashtim të Ligjit për qasje të lirë në informatat në Bosnjë dhe Hercegovinë, të gjitha vendet e rajonit e kanë të definuar obligimin ligjor për transparencë proaktive. Megjithatë, mosrespektimi i këtij obligimi, në kombinim me mekanizmat e dobëta për mbikëqyrje, e bën të pakuptimtë qëllimin e këtyre dispozitave ligjore. Kështu, ka autoritete që nuk kanë as edhe ueb faqe të tyre ose që nuk i shfrytëzojnë mjaftueshëm për ta informuar publikun me informata nga fushëveprimi i institucioneve. Ka shembuj të institucioneve të cilat nuk i përditësojnë rregullisht ueb faqet e tyre me lajme dhe ngjarje aktuale me muaj ose madje edhe vite, ku si të tilla japin shumë informata të shkurta pothuajse kurrfarë informatash për punën tyre.


Vërehen edhe probleme konkrete shumëvjeçare, në aspekt të transparencës financiare, duke filluar nga publikimi i informatave themelore për buxhetin vjetor dhe planet e prokurimeve publike. Gjendja është edhe më e pavolitshme në aspekt të publikimit të raporteve për mjetet e shpenzuara – p.sh. pothuajse dy të tretat e ministrive në rajon nuk publikojnë llogari përfundimtare.

Çështjet e menaxhimit të mjeteve nga rezervat buxhetore dhe përfitimet sociale ende janë të mbuluara me fshehtësi në vendet e rajonit.

Gjithashtu, shumë institucione nuk i prezantojnë planet e tyre vjetore të punës në publik, e as që raportojnë për atë që kanë punuar gjatë vitit. Më shumë se një e treta e institucioneve në rajon (37%) kanë publikuar në ueb faqet e tyre programet vjetore të punës për vitin 2021, si dhe raportet e punës (35,3%).


Kur bëhet fjalë për aktivitetet në rrjete sociale, madje 75% e institucioneve në rajon nuk shfrytëzojnë Twitter për ta informuar publikun për punën e tyre, ndërsa 43,1% nuk shfrytëzojnë as Facebook.

4.2. Gjendja e qeverisjes së mirë në institucionet e pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut



Në matjen e fundit të Indeksit të transparencës, krahasuar me 50 institucionet, edhe këtë vit sikurse vitin e kaluar, më e hapur është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila përmbush 82,71% të kriterëve të transparencës. Analizuar në aspekt rajonal, mesatarja e Qeverive për përmbushjen e treguesve është 57,17% rezultati është shumë i mirë, sepse tre vite radhazi në rajon, Qeveria e Maqedonisë së Veriut është në vendin e parë për përmbushjen e treguesve, që korrespondon me përpjekjet e Qeverisë së Maqedonisë për t'u orientuar drejt digjitalizimit të proceseve nëpër institucione, me qëllim të krijimit të sistemeve efikase dhe efektive të menaxhimit të mirë me transparencë dhe llogaridhënie të shtuar të menaxhimit të financave publike³³.

Gjithashtu, presioni dhe kushtëzimi i vendimit në procesin e aderimit në BE, kontribuoi që përmes reformave të administratës publike, theksi t'i vihet avancimit të transparencës, të cilat janë pjesë përbërëse e saj³⁴.



Shikuar në tërësi, ruajtja e vendit të parë për përmbushjen e treguesve të transparencës është rezultat edhe i përgatitjes dhe miratimit të disa akteve dhe mjeteve juridike³⁵ me të cilat direkt dhe indirekt është përcaktuar transparenca e pushtetit ekzekutiv

33 Programi i punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2022-2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Faqe8, E marrë nga: <https://cutt.ly/WKKSjQK>

34 Ka përparim të madh, veçanërisht me implementimin e Strategjisë për reforma në administratën publike (2018-2022), konsultimet e përmirësuara me publikun dhe transparencën e ritur në krijimin e politikave edhe në sferën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave. Prapë se prapë, respektimi i principeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit ligjor mbetet esencial. Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2018 nga Komisioni Evropian. E marrë nga: <https://cutt.ly/rKKSv9Z>

35 Strategjia për reformat e administratës publike (2018 – 2022), Programi i reformave për menaxhimin e financave publike 2022-2025, Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik (Gazeta zyrtare numër:101/2019), Strategjia për të dhëna të hapura 2018-2020, Portali <https://data.gov.mk/>, Politikat për 21 dokumente të cilat i obligojnë të gjitha ministritë për të publikuar sete me dokumente në ueb faqet e tyre si mjete për llogaridhënie dhe transparencë para publikut, ligji për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik, etj.

në Maqedoninë e Veriut. Vend të rëndësishëm në mesin e akteve të miratuara që e përcaktojnë përkushtimin për transparencë, kishte edhe Strategjia e miratuar për transparencë nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut (2019-2021)³⁶ që kishte për qëllim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të arrijë transparencë më të madhe të organeve qendrore të pushtetit ekzekutiv, si dhe të rritet besimi i qytetarëve ndaj Qeverisë, respektivisht ministrive, ndaj organeve tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve të pushtetit ekzekutiv, duke krijuar një ambient të transparencës dhe besimit. Sidoqoftë, implementimi i kësaj Strategjie ishte shumë më e kufizuar³⁷. Procesi u ndërpre me krijimin e Qeverisë teknike në shkurt të vitit 2020, para zgjedhjeve të shpallura parlamentare në prill të vitit 2020, e më pas edhe pandemisë me KOVID-19, që gjithashtu i prolongoi zgjedhjet e planifikuara në prill të vitit 2020. Gjithashtu, në stagnimin e implementimit të saj kontribuoi edhe mungesa e njësisë organizative për koordinim dhe monitorim të Strategjisë për transparencë, e cila duhej të formohet nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, si dhe mos formimi i grupit të punës për palët e interesuara për ndjekjen e zbatimit të saj, siç ishte e planifikuar me Planin e Veprimit.

Një karakteristikë që e shënoi vitin 2021 është miratimi i Planit të ri nacional të veprimit për Partneritet të pushtetit të hapur (2021-2023)³⁸ që synon vazhdimin e aktiviteteve në lidhje me avancimin e transparencës, llogaridhënies, proaktivitetit, inkluzivitetit, parandalimin e korrupsionit, qeverisjen e mirë, etj. Është krijuar edhe portali ovp.gov.mk që paraqet pikë qendrore për konsultim, monitorim, inkuadrim, lidhje në rrjet dhe njoftim të palëve të interesuara për procesin e bashkëkrijimit të planeve në kuadër të Partneritetit për pushtet të hapur. Nga ana tjetër, në vitin aktual, u përgatit edhe Strategjia Nationale për TKI 2021-2025 e Republikës së Maqedonisë së Veriut³⁹, që ka për qëllim ta përgatis Maqedoninë e Veriut për të ardhmen digjitale, por i analizon edhe aspektet e pandemisë së shkaktuar nga KOVID-19 që e përshpejtuuan digjitalizimin.

Vetvetiu, pavarësisht nga seria e dokumenteve strategjike për avancimin e transparencës, Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik siguron bazë të mjaftueshme për avancimin e transparencës proaktive dhe reaktive në mënyrë të pavarur. Shembull i këtillë është edhe krijimi i platformës “Thesar i hapur”⁴⁰ përmes së cilës bëhen publike të gjitha shpenzimet shtetërore, respektivisht me automatizëm publikohen të gjitha transaksionet e thesarit shtetëror, me çka ngrihet transparenca buxhetore dhe financiare.

Duke marrë parasysh se niveli i transparencës dhe llogaridhënies së arritur, së bashku, paraqesin tregues për integritetin, parandalojnë dhe ndikojnë në pengimin e korrupsionit gjatë shpenzimit të parave publike, respektivisht prokurimeve publike, ky indeks i kushton vëmendje të posaçme edhe vlerësimit të qasjes publike të buxhetit nga ana e institucioneve dhe procedurave të prokurimit publik. Është krijuar edhe një kornizë për luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e kulturës së integritetit, përmes Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Ligjit për Strategjinë

36 Strategjia e transparencës së Qeverisë së Maqedonisë së Veriut (2019-2021). Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. E marrë nga: <https://cutt.ly/eKKSTSu>

37 Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë së transparencës së Qeverisë (2019-2021). Fondacioni Metamorfozis. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/dKKSP7i>

38 Plani nacional i veprimit për POV (2021-2023). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/dKKDos0>

39 Drafti i Strategjisë Nationale për ITK 2021-2025. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. E marrë nga: <https://mioa.gov.mk/?q=mk/node/3470>

40 Financa të hapura. Ministria e Financave. Shkarkuar nga: <https://open.finance.gov.mk/mk/home>

Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të interesave (2021-2025) me Planin e Veprimit⁴¹, Udhëzimeve për realizimin e vlerësimit të rreziqeve nga korrupsioni⁴², Politikave të integritetit dhe udhëzimeve për zbatim⁴³ të përforcuar me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Strategjinë për promovimin e sistemit të sinjalizuesve⁴⁴, Ligjit për lobim, etj.

Kur flasim për pjesëmarrjen e qytetarëve, është konstatuar se Qeveria vazhdoi t'i implementojë rregullat e përcaktuara për përfshirjen e palëve të interesuara në krijimin e politikave, e kështu ta shfrytëzojë Regjistrin Nacional Elektronik (RNE) për konsultime të palëve të interesuara; vazhdoi me publikimi e thirrjeve për sektorin qytetar për kontribut në përgatitjen e Programit vjetor të punës së Qeverisë⁴⁵; Këshilli i Qeverisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Qytetare, rregullisht mbajnë seanca dhe jep raporte për punën e tyre⁴⁶, ndërsa përfaqësuesit e organizatave qytetare marrin pjesë në grupet e punës për krijimin e politikave të reja. Megjithatë, është i përgjithshëm edhe konkluzioni se kontrolli i kualitetit të konsultimeve publike dhe krijimi i procesverbaleve nga proceset konsultative, si dhe aktivitet i njëpasnjëshëm, janë të domosdoshme që të realizohen në të ardhmen⁴⁷, gjatë përcjelljes së procesit të konsultimeve.

Këtë vit sondazhi përmes Indeksit të transparencës tregon se rezultati i përgjithshëm i pushtetit ekzekutiv (përfshirë Qeverinë, ministritë dhe organet ekzekutive) arrin 60,93% me vlerësim më të lartë për treguesit e transparencës prej 55.65% dhe vlerësim më të ulët për qasshmëri prej 51.09%. Duke pasur parasysh se treguesit për qasshmëri e vlerësojnë deri në cilën shkallë e drejta e qasjes në informata është garantuar me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultime gjatë proceseve të krijimit të politikave, shumica e rekomandimeve të cilat i thekson ky dokument, në fakt, kërkojnë implementimin e politikave ekzistuese nga ministritë dhe organet ekzekutive. Vlerësimi më i ulët i treguesve për qasshmëri te pushteti ekzekutiv është si rezultat i stagnimit të implementimit të Strategjisë për transparencë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut (2019 – 2021), përkatësisht zgjatjes së procesit të modernizimit dhe barazimit të ueb faqeve të reja të ministrive dhe Qeverisë me ç'rast do të sigurohen mjete të reja digjitale dhe moderne për lehtësimin e transparencës proaktive të çdo institucioni⁴⁸.

Konkluzion tjetër i përgjithshëm i cili del nga mbikëqyrja e institucioneve në Indeksin e transparencës, që përsëritet disa vite me radhë, është ekzistimi i korrelacionit të drejtpërdrejtë ndërmjet hierarkisë së institucioneve dhe rënies së vlerësimeve të tyre. Organet ekzekutive kanë rezultat më të ulët sipas Indeksit, përkatësisht 41.54% përmbushje të treguesve, krahasuar me mesataren e ministrive që përmbushin 58.56%, dhe Qeveria që ka rezultat më të lartë dhe atë 82,71% përmbushje të treguesve.

41 Strategjia Nacionale 2021-2025. Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/IKKFqyl>

42 Udhëzimet për vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni institucional në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/PKKFazA>

43 Politika e integritetit të organeve shtetërore. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/JKK-Fc86>

44 Ibid.

45 Shkarkuar nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=mk/node/519>

46 E marrë nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=node/99>

47 Raporti i Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, nga Komisioni Evropian. Komisioni Evropian. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/tKKXp6K>

48 Parashihet që ky proces të përfundojë gjatë vitit 2022, faqe 54 nga Programi i punës së Qeverisë (2022-2024). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/WKKSjQK>

Që do të thotë se angazhimi dhe zbatimi i standardeve për transparencë janë në nivel të ndryshëm të strukturat e ndryshme të pushtetit ekzekutiv dhe prandaj koncepti i transparencës doemos duhet të zgjidhet në mënyrë sistimore. Nga mbikëqyrjet 33 organe ekzekutive, pothuajse 1/3 (9 organe ekzekutive) nuk kanë ueb faqe dhe në masë të madhe mbështeten në institucion adekuat për mbikëqyrje të dukshmërisë së punës së tyre. Është evidente se sa më e lartë që është hierarkia e institucioneve, aq më e madhe është mundësia që ajo të investojë mjete për dukshmërinë e punës së saj dhe për marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, duhet të potencohet se ky rezultat pjesërisht është si rezultat edhe i faktit që në këtë Indeks të transparencës përveç ueb faqes së Qeverisë vlerësohet edhe puna e Sekretariatit të Përgjithshëm, që i siguron mbështetje profesionale Qeverisë në tërësi, me qëllim për punë të ligjshme, efikase dhe transparente të Qeverisë.

Të dhënat më poshtë ofrojnë pasqyrë të rezultateve dhe arritjeve të institucioneve për çdo parim veçmas, dhe atë rezultati i transparencës, qasshmëria, efikasiteti dhe integriteti. Indeksi jep edhe analizë të thellë veçmas për çdo institucion dhe atë: e vlerëson arritshmërinë publike të informatave organizative, buxhetit dhe procedurave për prokurime publike (transparencë); e vlerëson deri në cilën shkallë e drejta e qasjes në informata është e garantuar me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirje dhe konsultime gjatë proceseve të krijimit të politikave (qasshmëria); e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset rrjedhëse dhe t'i përmirësojnë përmes sistemeve të vendosura për ndjekje, evaluim dhe mësim – me përdorim të pikave kryesore/treguesve gjatë planifikimit strategjik dhe njoftimit (efikasiteti); dhe e vlerëson prezencën e mekanizmave për parandalim të konfliktit të interesave, rregullim të lobimit, si dhe arritshmëri të kodit të sjelljes etike të cilin e udhëheq dhe sanksion sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe administratës publike (integriteti). Vlerë e shtuar e Indeksit për transparencë është që përmes analizës së të gjitha parimeve është vlerësuar edhe puna përmes praktikimit dhe përkushtimit të konceptit të të dhënave të hapura. Rezultatet janë marrë veçmas për çdo nivel të qeverisjes (Qeveri, ministri dhe organe ekzekutive), me ç'rast janë theksuar shembujt e mirë që theksohen në çdo grup.

Ministria e Mbrojtjes (81.88%), Ministria e Punëve të Brendshme (76.10%), Ministria e Arsimit dhe Shkencës (71.81%), Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (71.06%) dhe Ministria e Financave (71.06%) janë në 5 vendet e para në listën e renditjes në lidhje me përbushjen e treguesve⁴⁹.

4.2.1 Transparenca

Transparenca është koncept i gjerë i cili është i lidhur me arritshmërinë e informatave dhe me qasjen dhe përdorimin e informatave nga qytetarët, përkatësisht kërkuesit e informatave. E përkufizuar në këtë mënyrë ajo përfshin transparencën aktive, përkatësisht publikimin proaktiv të informatave nga institucionet publike, dhe transparenca pasive (reaktive), ku dhënia e informatave është iniciuar nga kërkuesi i informatave (përmes shfrytëzimit të të drejtës së qasjes në informata). Në esencë transparenca ndikon në uljen e korrupsionit, në rritjen e pjesëmarrjes së palëve të prekura në sjelljen e

49 Lista e renditjes e institucioneve me shkallë të përbushjes së treguesve të transparencës, shih Aneksi 1.

vendimeve, si dhe në rritjen e efikasitetit të institucioneve, përkatësisht shkallës së transparencës, mes tjerash, ndikon në qeverisjen e mirë. Përmes treguesve me të cilat vlerësohet arritshmëria publike e informatave organizative, pjesëmarrja e palëve të prekura në krijimin e buxhetit dhe transparenca në shpenzimin e buxhetit nga pushteti ekzekutiv, si dhe transparenca në procedurat për prokurime publike është vlerësuar pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministrinë dhe organet ekzekutive) me vlerësim më të lartë për treguesit për transparencë prej 55.65% përmbushje. Shikuar veçmas, organet ekzekutive janë më poshtë në shkallën në lidhje me përmbushjen e treguesve të transparencës me 42.92%, pastaj ministrinë me 55.92% dhe më lart është Qeveria me 68.13% përmbushje të treguesve të transparencës. Duke pasur parasysh se ueb faqet janë në mënyrë legjitime burimi kryesor i informatave për punën e institucioneve, ndërkaq janë mjet për qasje më të shpejtë, më të lehtë dhe më të sigurt, nuk mund të mos vërehet se ende ka institucione nga pushteti qendror të cilët nuk kanë ueb faqe. Dobësi e tillë serioze, me të cilën është pamundësuar publikimi i çfarëdo informatave proaktive për punën e organeve ekzekutive, konstatojmë se 9 nga 33 organe ekzekutive dhe prandaj ato janë më poshtë në shkallën e përmbushjes së treguesve. Duke pasur parasysh atë që shumica e treguesve të Indeksit të transparencës kanë të bëjnë me ueb faqet si burim i informatave, ky aspekt pasqyrohet dukshëm në rezultatin e tyre total. Kjo sqaron pjesërisht pse rezultati i përgjithshëm i organeve ekzekutive është më i dobët se ai i Sekretariatit të Përgjithshëm, përkatësisht Qeverisë ose ministrive.

4.2.1.1. Informata organizative

Institucionet janë transparente kur u mundësojnë qytetarëve, përkatësisht palëve të prekura, që të shohin dhe kuptojnë si funksionojnë dhe punojnë. Që të arrihet transparenca, organizata doemos duhet të sigurojë informata për kompetencën, aktivitetet dhe punën e saj të cilat janë të sakta, të plota dhe të arritshme në kohë. Ueb faqja e Qeverisë azhurnohet rregullisht dhe jep informata dhe të dhëna të rëndësishme për kompetencat që i kryen, të dhënat kryesore për kontakt, të dhënat për funksionarët (jetëshkrimet), listat e të punësuarve me pozitën, emaili dhe telefoni, ligjet që kanë të bëjnë me kompetencat, rregulloret për organizimin e brendshëm, për sistematizimin e vendeve të punës, si dhe organogramin për organizimin e brendshëm. Në ueb faqen e Qeverisë janë siguruar detaje për kontakt për nëpunësit shtetërorë dhe njësitë në Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe janë publikuar pagat e funksionarëve në Qeverinë⁵⁰. Seancat qeveritare janë shoqëruar me agjenda të publikuara paraprakisht, e pastaj edhe me procesverbale nga mbledhjet dhe njoftime për mediat. Megjithatë, ka hapësirë për përmirësim, duke i ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare, duke pasur parasysh se ende nuk publikohen dokumentet që shqyrtohen dhe diskutohen gjatë seancave të Qeverisë, as që publikohen transkripta nga mbledhjet. Qeveria duhet të mendojë për vendosjen e kanalit që do t'i mundësojë publikut ta ndjekë drejtpërdrejt miratimin e vendimeve për politikën që ndikojnë drejtpërdrejt mbi to.

Sa i përket cilësisë së ueb faqeve të ministrive, të gjithë janë vlerësuar pozitivisht për rregullshmërinë e përditësimit të ueb faqeve të tyre, ndërsa Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive janë

50 Pagat e Kryetarit dhe ministrave në Qeveri. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarko nga: <https://vlada.mk/plati>

veçuar si shembull negativ për kërkuesit jofunksional të ueb faqeve. Numri i ueb faqeve zyrtare ndërmjet organeve ekzekutive me kërkuesit funksionalë është 17 nga 24 organe që kanë ueb faqe (24 nga ekzemplari nga 33 institucione që u mbikëqyrën), përkatësisht ¼ nuk kanë kërkues funksional.

Ministritë, përveç Ministrisë së Shëndetësisë, i publikojnë jetëshkrimet e ministrave, ndërsa te organet ekzekutive rezultati është më i dobët, përkatësisht vetëm 15 i publikojnë jetëshkrimet e drejtorëve të tyre. Të gjithë ministritë i kanë publikuar organogramet e ministrisë, ndërsa te shumica është dhënë përshkrim i kompetencave të ministrisë, që nuk është rast te Ministria e Kulturës dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të cilët nuk kanë publikuar përshkrim të kompetencave të ministrisë. Shumica e organeve ekzekutive (70%) gjithashtu i kanë publikuar organogramet e institucioneve. Të dhënat e përditësuara për kontakt të nëpunësve shtetërorë mungojnë te të dyja ministritë (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive) dhe 13 organe ekzekutive.

Gjysma e ministrive publikuan programe vjetore për punën, e ulët është përqindja 43% (7 nga 16) e atyre nuk kanë publikuar raporte vjetore për punën e tyre. Ende është më i dobët rezultati kur bëhet fjalë për publikimin e programeve vjetore për punën te organet ekzekutive ku vetëm 36% të organeve ekzekutive i kanë publikuar, ndërsa 24% të organeve ekzekutive publikojnë raporte vjetore për implementimin e këtyre programeve. Në lidhje me raportet tremujore ose gjysmëvjetore publikohen rrallë: ndërmjet ministrive, Ministria e Financave dhe Ministria së Mbrojtjes publikojnë rregullisht raporte; ndërsa te organet ekzekutive vetëm 5 (15%) prej tyre theksohen si shembull i mirë (Inspektorati Shtetëror i Ndërtimitarisë dhe Urbanizmit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor).

Informatat për pagat e ministrive mungojnë në ueb faqet e 13 ministrive, megjithëse është e paqartë pse kjo nuk është bërë kur të dhënat janë të arritshme publikisht në ueb faqen e Qeverisë⁵¹. Në ueb faqet e veçanta të ministrive, janë publikuar pagat e ministrive të punëve të brendshme për mbrojtje dhe për vetëqeverisje lokale. Nga organet ekzekutive asnjë prej tyre nuk e ka publikuar këtë të dhënë për lartësinë e rrogave të drejtorëve. 3 ministritë (Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave) kanë publikuar Strategji komunikimi (PR). Në krahasim me matjen paraprake, ekziston observim i përgjithshëm se institucionet e kanë ruajtur nivelin e informatave të publikuara, por pritej ta përmirësojnë.

Së këndejmi, Ministria e Mbrojtjes (80.99%), Ministria e Financave (74.79%) dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (70.65%) janë në 3 vendet e para në listën e renditjes lidhur me përmbushjen e treguesve të transparencës. Te organet ekzekutive, përmbushja më e lartë e treguesve për transparencë është arritur nga Inspektorati Shtetëror i Ndërtimitarisë dhe Urbanizmit (70.75%), Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (70.72%) dhe Komisioni për Komunikim me Komunitetet Fetare dhe Grupet Religjioze (70.72%).

4.2.1.2. Buxheti

Duke pasur parasysh se transparencja gjatë planifikimit dhe zbatimit të financave publike është element kryesor për qeverisjen e mirë në këtë Indeks të transparencës përmes një sërë treguesish është matur transparencja buxhetore e pushtetit qendror. Gjegjesisht, transparencja buxhetore është e rëndësishme në aspekt të informimit të tatimpaguesve, përkatësisht qytetarëve, për atë për çfarë dedikimi institucionet i planifikojnë dhe i shpenzojnë mjetet e tatimpaguesve. Gjithashtu, është matur zbardhja në kohë dhe sistemet e informatave fiskale relevante, sepse kjo kontribuon për uljen e korrupsionit, si dhe për sigurimin e pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në proceset buxhetore.

Për shkak të rritjes së transparencës dhe përafrimit më të madh të informatave për shpenzim të buxhetit shtetëror ndaj qytetarëve dhe të gjithë palëve të interesuara, e gjithashtu edhe për shfrytëzimin e të dhënave për qëllime analitike, shkencore dhe hulumtuese Ministria e Financave i hapi të dhënat ndaj publikut përmes portalit “Financa të hapura” me çka iu mundësua publikut qasje në të dhënat për realizim të transaksioneve të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë të buxhetit shtetëror me të cilat disponon thesari.

Në ueb faqen e Qeverisë është publikuar buxheti shtetëror rrjedhës, por janë përfshirë edhe të dhëna historike për buxhetet për 14 vitet e fundit. Te Ministria e Financave si ministri kompetente, është publikuar buxheti shtetëror në format të hapur, por gjithashtu në ueb lokacionin <http://budget.finance.gov.mk> që është vendosur në vitin 2017, dhe këtë vit në mënyrë të kuptueshme është publikuar buxheti për qytetarët në formë të Buxhetit qytetar, të cilin e shpërndan buxheti shtetëror sipas klasifikimit ekonomik, pastaj sipas sferës funksionale, sipas shfrytëzuesve buxhetorë, si dhe është dhënë pasqyrë e iniciativave buxhetore gjinore. Praktika për publikimin e Buxhetit qytetar është ruajtur edhe nga Qeveria⁵². Gjithashtu, janë publikuar edhe dokumente për reformën e planifikuar dhe rrjedhëse të menaxhimit me financat publike. Lidhur me raportet financiare edhe ato publikohen në mënyrë periodike në ueb faqen e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, që do të thotë 80% tjerat nga ministria duhet ta fusin këtë praktikë. Sa u përket ministrive tjera, buxhetin, përkatësisht plan financiar nuk kanë publikuar Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, si dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive. Mbetet rekomandimi nga viti i kaluar me qëllim të avancimit të konsultimeve me publikun gjatë planifikimit të buxhetit të futen konsultime publike, si dhe të publikohen informata për shpenzimin e rezervave buxhetore.

51% të organeve ekzekutive publikojnë rregullisht plane financiare vjetore, e sa i përket njoftimit, 42% prej tyre publikojnë llogari përfundimtare, e vetëm një prej tyre, Sekretariati për Çështje Evropiane publikon raporte financiare periodike në ueb faqen e tij.

52 Buxheti qytetar 2021-1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/kKKF6cP>

4.2.1.3. Procedura për prokurime publike

Prokurimet publike janë cekur si të parët prej disa prioriteteve, sfera horizontale me rrezik të lartë korrupsioni në Strategjinë Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit⁵³ 2021-2025. Në Programin për reformë të menaxhimit të financave publike (2018-2021) u përfshinë qëllimet, masat dhe aktivitetet në sferën e prokurimeve publike. Dhe, në fillim të vitit 2021, në “Planin për luftën kundër korrupsionit – Aksioni 21”, Qeveria, me propozim të shoqërisë qytetare, përfshiu disa masa kundër korrupsionit në fushën e prokurimit publik, me të cilat i obligoi të gjitha autoritetet kontraktuese të zhvillojnë procedura të brendshme për zbatimin e procedurave për prokurimin publik dhe për realizimin e marrëveshjeve. Sistemi i prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i zhvilluar mirë, me kornizë të vendosur ligjore dhe institucionale. Transparenca e sistemit forcohet nga Sistemi i vendosur elektronik i Prokurimit Publik, i cili përfshin gjithashtu modul të ankesës elektronike.

Byroja për Prokurime Publike është institucioni i vetëm i ngarkuar për t’i publikuar dokumentet lidhur me procedurat për prokurime publike përmes Sistemit elektronik për prokurime publike, megjithëse si praktikë e mirë pritet që institucionet të sigurojnë qasje në to edhe përmes ueb faqeve personale. Prandaj, në Strategjinë për transparencë të Qeverisë (2019-2021), në kapitullin transparenca aktive, është përcaktuar përcaktim i veçantë strategjik për lidhjen e të dhënave në ueb faqen e ministrive dhe trupave tjera me ato që janë vendosur në Sistemin elektronik për prokurime publike.

Por, ende ekziston konstatimi për probleme dhe shkelje të shpeshta⁵⁴ në procedurat për prokurime publike të cilat duhet të tejkalohen edhe me implementimin e kornizës së re ligjore dhe Strategjisë së miratuar për avancim të sistemit të prokurimeve publike⁵⁵ në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022-2026) dhe Plan veprimin, si dhe të ndërmerren masa konkrete në standardizimin e prokurimeve publike⁵⁶.

Indeksi i transparencës, përmes një sërë treguesish në këtë sferë, vlerësimin për arritjet e pushtetit qendror e formon përmes planeve, thirrjeve, vendimeve, kontratave dhe anekseve të arritshme publikisht, përkatësisht të publikuara për prokurimet publike në ueb faqet e institucioneve. Krahasuar, ministrinë kanë arritje më të mira nga organet ekzekutive në lidhje me transparencën për procedurat e tyre për prokurime publike, por nga ana tjetër krahasuar me vitin e kaluar organet ekzekutive e kanë përmirësuar dukshëm transparencën në prokurimet publike.

Qeveria përmbush 10 nga 13 tregues në këtë nënkategori, me dobësi kryesisht në atë se anekset e lidhura të marrëveshjeve për prokurimet publike nuk janë publikuar në ueb faqen, si dhe ende nuk janë publikuar pronarë të vërtetë të ofertuesve dhe firmave që kanë lidhur marrëveshje me institucionet në procedurë për prokurim publik.

53 Strategjia Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit është miratuar nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në dhjetor 2020, dhe e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në prill 2021.

54 Raporti në hije për prokurim publik 2021, Qendra e Komunikimeve Qytetare. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/vKKGy53>

55 Strategjia për avancimin e sistemit të prokurimeve publike 2022-2026. Byroja e Prokurimeve Publike. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/bKKGhWJ>

56 Gërkovska: Na nevojitet sistem për prokurime publike dhe standardizim që të mos ketë keqpërdorime. Tellma. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/lKKGchs>

Qeveria është vlerësuar pozitivisht për publikimin e planeve, thirrjeve, vendimeve dhe marrëveshjeve për prokurimet publike në ueb faqen e saj. Qeveria gjithashtu ka praktikë pozitive dhe e publikon raportin e fundit vjetor për të gjithë prokurimet publike.

Disa vite më herët me qëllim të përmirësimit të procedurës për prokurime publike dhe uljes së mundësisë për keqpërdorim të mjeteve është dhënë rekomandim, që përsëritet edhe këtë vit, nëpunësit që realizojnë prokurime publike të jenë të obliguar të plotësojnë deklaratë për konflikt interesash dhe të parashtrojnë lista anketuese për gjendjen pronësore. Gjithashtu, përsëritet rekomandimi për nevojën që të publikohen publikisht pronarët e vërtetë të firmave që kanë lidhur prokurime publike në Sistemin elektronik për prokurime publike, me çka do të parandalohet korrupsioni, do ta ulë dukshëm keqpërdorimin e ofertave për prokurime publike dhe do të shërbejë të sigurojë konkurrencë të drejtë ndërmjet ofertuesve, e që si masë është paraparë edhe në Plan veprimin e pestë nacional për Partneritet për qeveri të hapur (2021-2023)⁵⁷.

Tabela më poshtë jep pasqyrë deri në cilën shkallë ministrinë dhe organet ekzekutive i përmbushin treguesit që e vlerësojnë transparencën në procedurat për prokurime publike. Ekziston përmirësim i plotë i performancave edhe i ministrive dhe në veçanti të organeve ekzekutive krahasuar me vitin e kaluar. Lidhur me publikimin e raporteve vjetore nga organet ekzekutive, në të dyja nivelet ka rritje të numrit të institucioneve që publikojnë raporte vjetore për prokurime publike. Në krahasim me vitin e kaluar, asnjë ministri nuk ka publikuar raport vjetor për prokurimet publike, kjo matje tregoi se Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive kanë vepruar sipas rekomandimeve të Indeksit të transparencës dhe kanë publikuar raporte vjetore për prokurime publike. Megjithëse ky nuk është obligim ligjor, por është praktikë e mirë ndërkombëtare dhe institucionet duhet të vazhdojnë me angazhimin për përcaktimin e tij si praktikë. Prandaj, mbetet rekomandimi, që institucionet të bëjnë raport përmbledhës vjetor* për të gjitha prokurimet publike për vitin paraprak.

57 Plan veprimi nacional për PQH (2021-2023). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/dKKDos0>

PROCEDURAT PËR PROKURIME PUBLIKE: MINISTRI DHE ORGANE EKZEKUTIVE		
	Ministri	organe ekzekutive
A janë publikuar në ueb faqe planet për prokurime publike?	94% ⁵⁸ ↓	60% ↔
A janë të arritshme publikisht në ueb faqe thirrjet për prokurime publike?	81% ↔	60% ↑
A janë të arritshme publikisht në ueb faqe vendimet për prokurime publike?	81% ↑	57% ↑
A janë të arritshme publikisht në ueb faqe marrëveshjet për prokurime publike?	81% ↔	39% ↑
A janë të arritshme publikisht në ueb faqe anekset e marrëveshjeve për prokurime publike?	56% ↓	60% ↑
A është i arritshëm në ueb faqe raporti i vjetor* për të gjitha prokurimet publike?	75% ↑	24% ↑

* Megjithëse institucionet bënë hap pozitiv në këtë drejtim me atë që kryesisht integruan pjesë të portalit për prokurime publike, nevojitet që të publikojnë raporte të veçanta vjetore për të gjitha prokurimet publike në dokument të veçantë në format të hapur.

4.2.2. Qasshmëria

Indeksi i transparencës në nënkategorinë qasshmëria shkallën e transparencës e mat përmes treguesve me të cilat e vlerëson deri në cilën shkallë garantohet e drejta e qasjes në informata me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për angazhim dhe konsultime me publikun në proceset e krijimit të politikave. Konkluzion i përgjithshëm është se për herë të parë këtë vit sondazhi përmes Indeksit të transparencës tregon vlerësim më të ulët mesatar të pushtetit ekzekutiv (përfshirë Qeverinë, ministrinë dhe organet ekzekutive) në arritjen e nënkategorisë qasshmëria prej 51.09% përmbushje të treguesve. **Në vlerësimin e ulët mesatar ndikojnë përmbushja e ulët e treguesve**

58 Këtë vit vetëm Ministria e Punëve të Jashtme nuk e ka publikuar planin për prokurime publike në ueb faqen e tyre.

të qasshmërisë nga organet ekzekutive (31.11%) dhe nga ministritë (40.61%). Për dallim prej tyre Qeveria përmbush 81.56% të treguesve të qasshmërisë. Sipas përfshirjes së nënkategorisë Qeveria kryesisht vlerësohet për cilësinë e kornizës juridike e cila e garanton të drejtën e qasjes në informata, si dhe praktikën e saj, dhe rezultatet e ministrive dhe organeve ekzekutive mbështeten plotësisht në shkallën deri në të cilën ato i praktikojnë dispozitat juridike dhe standardet ndërkombëtare të mbikëqyrura përmes Indeksit të transparencës. Prandaj, shumica e rekomandimeve të cilat ky dokument i thekson, në fakt, kërkojnë implementim efikas të politikave ekzistuese nga ministritë dhe organet ekzekutive.

Në veçanti, te ministritë, Ministria e Mbrojtjes (61.05%), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (56.54%) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (53.08%) janë në 3 vendet e para në listën e renditjes lidhur me përmbushjen e treguesve të qasshmërisë. Te organet ekzekutive, përmbushje më të lartë të treguesve për qasshmëri është arritur nga Enti Shtetëror i Statistikës (54.67%), pastaj vijnë Byroja e Zhvillimit Rajonal (53.33) dhe Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizimit (50.67%).

4.2.2.1. Qasja në informatat

Qasja në informatat është komponent kryesor i transparencës dhe pushtetit të përgjegjshëm. Kuptimi i qasjes në informatat është që t'u mundësojë qytetarëve të shohin si punon pushteti, përkatësisht të kenë mundësi të zbulojnë korrupsion ose të zbulojnë mangësi gjatë krijimit të politikave. Në atë kuptim, informatat që i krijojnë dhe me të cilat disponojnë autoritetet publike i përkasin publikut. Në Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik⁵⁹ nga viti 2019 u zgjerua lista e poseduesve të informatave; u përcaktua lista më e gjerë e informatave të cilën institucionet janë të obliguar ta publikojnë në mënyrë proaktive; është definuar interesi publik; u shkurtua afati për përgjigje të kërkesës në 20 ditë; u shkurtua lista e përjashtimeve nga qasja e lirë; si dhe u përcaktuan kompetenca të zgjeruara të organit të shkallës së dytë me mundësi për të udhëhequr procedurë për kundërvajtje, e me qëllim të sigurimit të publicitetit dhe transparencës së institucioneve, me rezultat – qytetar i informuar. Ky Ligj përcakton obligim që poseduesit e informatave të përgjigjen në kërkesat për qasje në informatat me karakter publik (qasja reaktive), por përmban edhe dispozita për publikim proaktiv të informatave, përkatësisht publikim të pavarur të informatave, të njohur si transparencë aktive.

Indeksi i transparencës përmes ueb faqeve i vlerëson institucionet nga pushteti qendror (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) a kanë informata të përditësuara për realizim të të drejtës për qasje të lirë në informatat; nëse i publikojnë kërkesat tashmë të përgjigjura për qasje të lirë; si dhe nëse në ueb faqen kanë seksion të veçantë të dedikuar për të drejtën e qasjes në informatat (ose emër tjetër) ku janë përfshirë informatat relevante; a kanë publikuar listë të përditësuara të informatave etj. Ueb faqja e Qeverisë në tërësi i përmbush kriteret për realizim të të drejtës për qasje të lirë, e si dobësi është e evidentuar ajo që nuk i publikon përgjigjet të cilat i përgatit për kërkesat për qasje të lirë në informatat. Kjo praktikë është e vërejtur te Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e nga organet ekzekutive vetëm te Enti Shtetëror i Statistikës. Mund të konkludohet se në lidhje me praktikën,

59 Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.101/2019 nga 22.05.2019

dobësi e përgjithshme e cila vërehet te të gjitha institucionet nga pushteti ekzekutiv është dështimi për t'i publikuar në ueb faqe përgjigjet me të cilat kanë siguruar qasje në informatat pas kërkesës së parashtruar.

Marrë parasysh trendët e rinj dhe proceset e digjitalizimit që ndodhin në botë, e që imponohen si nevojë edhe te ne, është e pritur që së shpejti të vihet theksi gjithnjë e më shumë në transparencën aktive, e cila duhet ta ulë dukshëm numrin e kërkesave të parashtruara për qasje të lirë. Së këndejmi, do të duhet të ndiqen edhe praktikrat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me kohën e pritjes për përgjigje të kërkesës në letër për qasje të lirë, që lëviz ndërmjet 7 dhe 15 ditësh, dhe do të nevojitet që te ne të intervenohet përsëri në afatin, dhe nga 20 ditë të shkurtohet koha e pritjes më së shumti në 15 ditë. Që të vlerësohet koha e pritjes për kërkesën e parashtruar nga institucionet e targetuara, Metamorfozis dërgoi kërkesa për qasje në informata në të gjitha 50 institucionet, e 46% prej tyre janë përgjigjur në kohë. Nga institucionet të cilat nuk dhanë përgjigje në kohë ose janë përgjigjur pas afatit ligjor janë 6 ministri nga të cilat 4 u përgjigjën pas afatit ligjor, ndërsa 2 aspak nuk u përgjigjën (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës) dhe 14 organe ekzekutive nga të cilat 7 u përgjigjën pas afatit ligjor, ndërsa 7 aspak nuk u përgjigjën kërkesave.

Si në vitin e kaluar, të gjithë ministrinë (93.75%), përveç Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, në ueb faqet e tyre kanë krijuar hapësirë të veçantë (seksion) të përkushtuar në procedurën me kërkesën për qasje të lirë në informatat. Në krahasim me vitin e kaluar kur 68.75% të ministrive kanë paraqitur se kanë staf të trajnuar për procedurën e qasjes së lirë në informatat. Këtë vit ka rënie të vogël në rezultatet dhe është 62.5% përkatësisht numri i ministrive që e kanë trajnuar stafin e tyre është 10 (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive). Edhe Qeveria e ka vazhduar praktikën për t'i trajnuar nëpunësit e tyre për procedurën për qasje të lirë në informatat.

Sa u përket organeve ekzekutive, pa ndryshim nga viti i kaluar, 39% prej tyre kanë pjesë të veçantë në ueb faqen në lidhje me procedurën për qasje të lirë në informatat. Numri i vogël i stafit të trajnuar për procedurën për qasje të lirë është i dukshëm te organet ekzekutive ku vetëm pesë institucione (15%) nga 33 të monitoruara njoftuan se kanë ndjekur trajnime për qasje të lirë, dhe atë: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Sekretariati për Legjislacion, Byroja e Prokurimeve Publike, Byroja e Rezervave të Mallrave dhe Drejtoria e Ekonomisë së Ujërave.

4.2.2.2 Bashkëveprimi me qytetarët

Në shoqërinë e sotme globale, i pakontestueshëm është roli i mediave digjitale, e në veçanti rrjetet sociale në këmbim dhe diseminim të informatave, rritja e vetëdijes publike për çështje me interes publik, njoftimi i qytetarëve me fushëveprimin e punës së institucioneve dhe hapja e mundësive që ato të participojnë në proceset e krijimit të politikave, si dhe shfrytëzim i thjeshtë dhe i shpejtë i shërbimeve. Prandaj, në nënkategorinë e qasjes është mbikëqyrur shkalla deri në të cilën institucionet e lehtësojnë bashkëveprimin dhe ofrimin e shërbimeve qytetarëve.

Natyra dhe shfrytëzimi frekuentues i ueb faqeve dhe mjetet tjera online (Facebook, Twitter dhe shumë tjera) i vë në pozitën qendrore për bashkëveprim me qytetarët, por mbikëqyrja tregoi mangësi kur bëhet fjalë për kanalet për komunikim të shpejtë. Gjithashtu, kanal të drejtpërdrejtë në ueb faqet për komunikim online përmes të cilit qytetarët mund të shprehin shqetësim, të dërgojnë parashtrësia ose ankesa ka Qeveria, vetëm 4 (24%) ministri (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave) dhe 10 organe ekzekutive (30%). Në vitin 2021 nuk është vërejtur përditësim të Strategjisë së Komunikimit të Qeverisë 2019/2020⁶⁰ e cila, mes tjerash, duke standardizuar mënyrën e transmetimit të mesazheve dhe duke i bazuar komunikimet me qytetarët në parimin e 'qeverisë së hapur', ka kontribuar në rezultatet më të mira të Qeverisë në Indeksin e transparencës në krahasim me ministritë tjera dhe autoritet tjera ekzekutive. Përveç kësaj, u krijua portal uslugi.gov.mk, i cili nuk promovohet në mënyrë aktive në mediat sociale.

Mediat sociale kontribuojnë në lehtësimin e komunikimit dhe bashkëveprimit me publikun, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk kompensojnë mungesën e ueb faqeve (9 nga 33 organe ekzekutive ende nuk kanë ueb faqe), as nuk mund të zëvendësojnë ueb faqet për sa i përket vëllimit të informatave të shpërndara. 34 nga 50 institucionet e mbikëqyrura qendrore kanë profile zyrtare në Facebook dhe 11 prej tyre kanë profile në Twitter. Mbetet konkluzioni nga viti i kaluar se po braktiset ngadalë praktika e përdorimit të vetëm të profileve personale të funksionarëve si zyrtarë në rrjetet sociale, por ato janë akoma më të pasura në informacione se sa kanalet zyrtare sociale të institucioneve. Problemi kryesor me profilet personale të zyrtarëve është se ato pushojnë së përdoruri si burim informacionesh dhe bashkëveprim me institucionet përkatëse sapo të mbarojë mandati i funksionarit dhe si të tillë nuk përmbajnë kujtime të gjata për ngjarjet në institucione.

Marrë parasysh se shoqëria qytetare është (duhet të jetë) partner i barabartë dhe korrektor i vendimeve të pushtetit, dhe se është i domosdoshëm dialog i vazhdueshëm, transparent dhe i plotësisht inkluziv me shoqërinë qytetare, Ministritë u mbikëqyrën përmes ueb faqeve të tyre në lidhje me atë nëse kanë publikuar përmbajtje për aktivitete të përbashkëta me shoqërinë qytetare në 6 muajt e fundit. Është konstatuar se shumica, 81.25% e ministrive publikojnë rregullisht përmbajtje të tilla për aktivitete të përbashkëta me shoqërinë qytetare.

Në lidhje me lehtësimin e shërbimeve publike, pushteti qendror në vazhdimësi e plotëson portalin online për shërbime elektronike, të arritshëm në www.uslugi.gov.mk, i cili shërben si regjistër i 838 shërbimeve publike, të siguruara nga 1288 institucione me instruksione të qarta për atë si të qaseni në to dhe për disa me mundësi të drejtpërdrejtë për qasje dhe siguri të shërbimeve përmes internetit. Ky mjet i rëndësishëm luan rol kryesor për të lehtësuar bashkëveprimin ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, me qëllim institucionet të jenë të orientuara në mundësimin e shërbimeve të arritshme lehtë për qytetarët si karakteristikë e qeverisjes së mirë. Përveç ueb faqeve kryesore të ministrive, te 75% prej tyre, gjithashtu janë të arritshme seksionet me lista të të gjitha shërbimeve që sigurohen përmes ministrive me linqe në përshkrimin e shërbimit dhe dokumentacionit të nevojshëm. Lloj të tillë të listave me shërbime elektronike të cilat

60 Strategjia e komunikimit të Qeverisë për vitin 2019/2020. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/komunikaciska-strategjia>

i ofrojnë organet tjera ekzekutive në ueb faqet e tyre kanë publikuar vetëm 2 organe ekzekutive (6%).

4.2.2.3. Konsultime publike

Pjesëmarrja në kohë dhe esenciale e qytetarëve në krijimin e politikave është parakusht që një shoqëri demokratike të njihet si transparente dhe llogaridhënëse. Nga njëra anë, përmes pjesëmarrjes së publikut në proceset e përgatitjes së politikave mundësohet që palët e interesuara të ndikojnë në zhvillimin e politikave që i interesojnë. Nga ana tjetër, përmes pjesëmarrjes së palëve të interesuara në këto procese, kreatorët e politikave marrin ide të reja, informata dhe qasje në resurset të rëndësishme në procesin e krijimit të politikave. Në fund, konsultimet kontribuojnë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe zhvillimin e parimeve demokratike.

Konsultimet realizohen në tre mënyra: (1) nëpërmjet njoftimit për fillimin e procesit, i cili është hapi i parë i konsultimit, ku publiku është një faktor pasiv, por lejon kohë për përgatitje për palët e interesuara; (2) përmes konsultimit, që nënkupton kërkim aktiv të mendimit dhe pikëpamjeve nga ata që janë të interesuar. Ky është në thelb një proces i mbledhjes së informatave, por edhe i dialogut të vazhdueshëm; dhe (3) përmes pjesëmarrjes aktive, përkatësisht përfshirjes së palëve të interesuara në procesin e krijimit të politikave. Në periudhën e kaluar janë krijuar disa mekanizma konsultativë, me përfaqësues nga shoqëria qytetare, të cilët kontribuojnë në procese konsultative më dinamike, si Këshilli për Koordinim dhe Monitorim të Partneritetit për Qeveri të Hapur⁶¹, Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Qytetare, Grupeve sektoriale të punës⁶², Këshilli Nacional për Reformat në Sferën Mediatike, Këshilli për Reformat në Drejtësi etj.

Në aspektin e akteve juridike⁶³, ekzistojnë disa të tillë që ofrojnë bazë për përfshirjen e publikut në proceset e krijimit të politikave, përkatësisht e rregullojnë këtë çështje, si p.sh: Rregullorja e Punës së Qeverisë së RMV-së, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim me shoqërinë qytetare⁶⁴, Kodi i praktikave të mira për pjesëmarrjen e sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave, Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullores, Udhëzimet për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e realizimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, Rregullorja për organizimin e konsultimeve publike gjatë fillimit të procesit legjislativ, etj. Regjistri i vetëm elektronik nacional i rregulloreve (RVEN) është kanali përmes të cilit zhvillohen konsultimet elektronike për propozim-ligjet.

Të gjitha ministritë janë të obliguara të publikojnë propozim-ligje në RVEN dhe në ueb-faqet e tyre zyrtare për konsultime publik për një periudhë prej së paku 20 ditësh para se të mund të vazhdojë procedura qeveritare. Komentet e mbledhura gjatë periudhës së konsultimeve me palët e interesuara përmbledhen gjithashtu në raportet e Vlerësimit

61 I vendosur për të prezantuar një qasje më të strukturuar ndaj proceseve të PQH-së duke maksimizuar pjesëmarrjen dhe angazhimin, si dhe duke monitoruar dhe orientuar realizimin e planeve të veprimit të PQH-së. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/LKKGXcO>

62 Dialogu ndaj BE-së. Grupet sektoriale të punës. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/iKKG06Y>

63 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për referendum dhe forma tjera të prononcimit të drejtpërdrejtë, Ligji për punën e Qeverisë së RMV-së, Ligji për organizim dhe punën e organeve të administratës shtetërore etj.

64 Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim dhe zhvillim të shoqërisë qytetare. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/DKKhGS>

të Ndikimit Rregullator (VNR) të ministrive që i propozojnë ato, me arsyet pse janë pranuar e pse jo. Në tetor 2021 Qeveria miratoi Raportin Vjetor për zbatimin e procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës - PVR (janar-dhjetor 2020), në të cilin u konstatua se procedura për PVR është respektuar për 121 propozim-ligje nga gjithsej 134 propozim-ligje që janë miratuar nga Qeveria.

Për shkak të ekzistimit të platformës qendrore, siç është RVEN, Qeveria dhe të gjitha ministritë janë vlerësuar pozitivisht për ofrimin e mundësisë për të kryer konsultime online. Megjithatë, nga ana e ministrive, përveç Ministrisë së Shoqërisë Informativë dhe Administratës, nuk ka asnjë seksion të veçantë në ueb faqet me informatat e nevojshme për lajmërimin e proceseve të krijimit të politikave me link të drejtpërdrejtë në RVEN. Vetëm në 6 ministri kemi vërejtur thirrje për debate publike në ueb faqet e tyre (37.5%), por asnjëra nuk publikon plane vjetore për debate publike. Raportet për konsultimet e kryera nuk publikohen në ueb faqet e ministrive, por ato janë të integruara në raportet e vlerësimit të ndikimit të rregullativës. Vetëm Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në seksion të veçantë në ueb faqe publikon procesverbalet e debateve publike të mbajtura me palët e interesuara⁶⁵. Sipas udhëzimeve për hartimin e planeve strategjike dhe planeve vjetore të punës, pritet të sigurohet planifikimi dhe zbatimi i koordinuar i politikave të Qeverisë nga organet e administratës shtetërore. Megjithatë, konkluzioni i përgjithshëm është se sistemi elektronik i konsultimeve publike nuk është përdorur në potencialin e tij të plotë, dhe kontrolli i cilësisë dhe monitorimi i procesit të konsultimeve me publikun duhet të përmirësohen⁶⁶.

4.2.3 Efikasiteti (planifikimi strategjik, njoftimi, monitorimi dhe evaluimi)

Efikasiteti është një vlerësim i përkushtimit të institucioneve për të planifikuar dhe mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit - duke përdorur qëllime kryesore - treguesit gjatë planifikimit dhe njoftimit strategjik. Në dy nënkategori përkatësisht: njoftim dhe monitorim dhe vlerësim, institucionet nga pushteti qendror janë vlerësuar: nëse kanë dorëzuar me kohë raport për zbatimin e programit të punës; nëse e kanë dorëzuar në kohë raportin financiar vjetor për vitin aktual; nëse përdorin tregues të performancës gjatë formulimit të programit vjetor, përkatësisht për raportin vjetor për punën për vitin e paraprak. Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë është vlerësuar lidhur me ekzistimin e mekanizmave dhe gjithë përfshirjes së kornizës juridike për planifikimin strategjik, krijimin dhe koordinimin e politikave. Duhet pasur parasysh bashkëveprimi me publikun dhe përfshirja e palëve të interesuara në proceset e krijimit të politikës, si dhe vlerësimi i ndikimit të rregullores, si parime të qeverisjes së mirë, të cilat u vlerësuan në kategorinë "qasshmëria" me përmbushje më të ulët të treguesve, ndikojnë dukshëm në performancat e institucioneve.

Procesi i planifikimit strategjik është mjet përmes të cilit përcaktohen strategjitë dhe politikat dhe miratohen vendime për prioritetet dhe qëllimet kryesore, si dhe

65 Procesverbalet nga debatet publike. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/ZKKHDdg>

66 Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 i Komisionit Evropian. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/tKKXp6K>

shpërndarjen e resurseve. Prandaj edhe thuhet se planifikimi strategjik është një prej hapave kryesore për përmbushjen e misionit, përkatësisht kompetencave të një institucioni. Monitorimi i zbatimit të politikave, si dhe konsultimet publike proaktive janë pjesë e sërës së njëjtë të zhvillimit të politikave përgjegjëse të bazuara në dëshmi. Në këtë nënkategori vëmendje të veçantë i kushtohet arritshmërisë së mekanizmave sistematike të cilat rregullisht i vlerësojnë ndikimin, shpenzimet dhe efektet e politikave dhe si të tilla shërbejnë për zhvillimin e planeve strategjike për të ardhmen, duke u mbështetur në të dhënat si dëshmi.

Korniza juridike për planifikim strategjik, krijimi dhe koordinimi i politikave⁶⁷ është definuar dhe e njëjta përfshin rregullativë të harmonizuar ligjore dhe nënligjore përmes të cilës sigurohen mekanizma dhe procedura efikase për zbatimin dhe ndjekjen e procesit me kompetencë të përcaktuar adekuate. Ministritë përgatisin plane strategjike (trevjeçare) afatmesme të cilat duhet t'i përmbajnë politikat e planifikuara me kompetencë të tyre dhe në bazë të të cilave duhet të planifikohet buxheti në sferën përkatëse. Megjithatë, ky proces zbatohet formalisht me ç'rast nuk i kushtohet vëmendje e veçantë lidhshmërisë së ndërsjellë të prioriteteve qeveritare dhe sektoriale, aktiviteteve të planifikuara dhe të ndërmarra për periudhën e ardhshme me shpërndarje adekuate të mjeteve të nevojshme⁶⁸.

Planifikimi strategjik u ndihmon ministrive dhe organeve ekzekutive që në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme t'i planifikojnë programet, projektet dhe aktivitetet e parapara në Programin nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA)⁶⁹, ta ndjekin realizimin e tyre dhe t'u përshtaten të gjitha ndryshimeve. Në fakt, në planet strategjike të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore duhet të përpunohen hollësisht masat dhe aktivitetet që janë paraparë në NPAA, përkatësisht të sigurohet harmonizim i dy akteve⁷⁰.

Sekretariati i Përgjithshëm ndjek kornizë për monitorim dhe vlerësim sipas së cilës ato e planifikojnë dhe e paraqesin punën e tyre në nivel vjetor. Plani strategjik i Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së për periudhën 2022-2024 është harmonizuar me Buxhetin e RMV-së⁷¹. Gjithashtu, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë dhe Raporti për zbatimin e Planit vjetor për punë të Qeverisë për vitin 2021⁷². Raporti përmban informata

67 Ligji për Qeverinë, Ligji për buxhetet, Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Metodologjia për analizë dhe koordinim të politikave ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 56/06), Metodologjia për planifikim dhe përgatitje strategjike të Programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/08 dhe 58/18), Udhëzues për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së RM-së" nr. 131/18), Udhëzime për përgatitjen e planeve strategjike të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore, Udhëzues për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore në procesin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit për zbatimin e planit strategjik dhe të planit vjetor të punës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 130/18), Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullativës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 107/13 dhe 173/17), Metodologjia e Vlerësimit të zbatimit të rregullativës (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 2013), Udhëzues për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e realizimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 106/13), Vendimi për formën dhe përmbajtjen e Raportit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 106/13), Kodi i Praktikave të Mira për pjesëmarrjen e sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 99/11, Rregullorja për organizimin e konsultimeve publike gjatë fillimit të procesit legjislativ.

68 Strategjia për reforma në administratën publike (2018-2022). Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/hKKHZkd>

69 Baza të të dhënave. Sekretariati për Çështje Evropiane. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/RKKH4QL>

70 Doracaku për planifikim strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/LKKHC6r>

71 Planifikim strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar: <https://cutt.ly/PKKJffn>

72 Raport për realizimin e planit vjetor të punës së Sekretariatit të Përgjithshëm për vitin 2021. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/xKKJj6W>

të përgjithshme për arritjen e rezultateve, ndërsa të dhënat nuk janë publikuar në format të hapur.

Nëpërmjet treguesve të efikasitetit, pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) është vlerësuar me 54,66% përmbushje të treguesve. Shikuar individualisht, organet ekzekutive në këtë kategori janë në fund të shkallës për sa i përket përmbushjes së treguesve të efikasitetit me 33,79%, më lart janë ministritë me 50,31% përmbushje të treguesve dhe më lart është Qeveria me 79,90% përmbushje të treguesve të efikasitetit.

Lidhur me përdorimin e treguesve për sukses gjatë planifikimit 56.25% nga ministritë njoftojnë se i aplikojnë, e gjysma e tyre (50%) përdorin edhe tregues për sukses gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre. Më i ulët është rezultati te organet ekzekutive, përkatësisht 1/3 e organeve ekzekutive njoftojnë se shfrytëzojnë tregues të suksesit gjatë planifikimit dhe ¼ e tyre shfrytëzojnë tregues për sukses gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.

56% nga ministria kanë parashtruar në kohë raport për implementimin e programit për punë në Qeverinë, dhe 62.5% prej tyre kanë parashtruar në kohë raport financiar vjetor për vitin rrjedhës. Përmbushja nga organet ekzekutive është më e dobët, përkatësisht 45.45% kanë parashtruar në kohë raport, dhe 51.5% kanë parashtruar në kohë raport financiar për vitin rrjedhës.

Mbetet e domosdoshme të përforcohen kapacitetet institucionale dhe njerëzore për koordinim të procesit për planifikim afatmesëm dhe lidhje me strategjitë sektoriale, buxhetimin dhe planifikimin vjetor. Në fund, mbetet i pamjaftueshëm përforcimi i rolit të Sekretariatit të Përgjithshëm si trup qendror për koordinim dhe kontroll të cilësisë⁷³.

4.2.4. Integriteti

Korrupsioni është një prej problemeve më korroziv në kohën e sotme. Korrupsioni shpie në politika të gabuara publike, i shpenzon resurset në mënyrë të panevojshme, i zgjeron pabarazitë ekonomike dhe sociale, krijon pakënaqësi dhe polarizim politik dhe e zvogëlon besimin në institucionet të cilat duhet t'i shërbejnë interesit publik.

Qasjet tradicionale, bazuar në krijimin e sa më shumë rregullave, harmonizimi më i rreptë i legjislacionit dhe zbatimi më i rreptë me sa duket kanë efikasitet të kufizuar. Shumë autorë që e hulumtojnë temën konstatojnë se përgjigja strategjike dhe e qëndrueshme e korrupsionit doemos duhet të jetë integriteti publik⁷⁴.

Integriteti është pasqyrë e vlerave të individëve dhe institucionit dhe si i tillë është vështirë për t'u definuar dhe kontrolluar. Por, në esencë, integriteti nënkupton kryerje të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të punëve me të cilat personat zyrtarë e ruajnë autoritetin e tyre dhe të institucionit në të cilin janë ose personi përgjegjës ose të punësuarit, i eliminojnë rreziqet dhe i mënjanojnë dyshimet në mundësinë nga paraqitja dhe zhvillimi i korrupsionit dhe me atë sigurojnë

73 Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 të Komisionit Evropian. Komisioni Evropian. Faq. 13. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/tKKXp6K>

74 Rregullat dhe kushtet, OECD. Shkarkuar nga: <https://www.oecd.org/termsandconditions/>

besim të qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike⁷⁵. Nga pikëpamja e sotme, kur shteti tregoi trend të përmirësimit të pozitës së tij në luftën kundër korrupsionit⁷⁶, është me rëndësi të krijojë dhe imponojë vizion për strategji për integritet publik, duke e mënjanuar fokusin nga politikat ad-hok për integritet, përmes qasjes e cila është e bazuar në kulturën e integritetit. Prandaj është me rëndësi që të ekzistojnë mekanizma të cilat do të parandalojnë raste të ekspozimit të mitës (ryshfetit) dhe shfrytëzimit të lidhjeve personale, deri te praktikat e përhapura gjerësisht të nepotizmit, kronizmit, klientalizmit, përkatësisht keqpërdorimit të ndikimit politik që ndodh ndërmjet elitave⁷⁷. Një pjesë e këtyre mekanizmave janë politikat për integritet, Kodet Etike, rregullat për mbrojtje të sinjalizuesve, mekanizmat për parandalim të konflikteve të interesave, rregullim të lobimit etj. Prandaj në këtë nënkategori mbikëqyren si mënyra përmes të cilave mund të parandalohet dhe kontrollohet dukuria e ndikimit politik, përkatësisht keqpërdorimit të fuqisë.

Qeveria ka përbushje të lartë të pikave të indeksit në këtë nënkategori me 84.6% sepse u vlerësua për ekzistimin dhe arritshmërinë e politikave që ndikojnë në parandalimin e korrupsionit, ndërtimin e sistemit të integritetit, rregullat për publikim të fletanketave nga funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar të dorëzojnë të dhëna për gjendjen e tyre pronësore, e për të cilat është mundësuar të publikohen⁷⁸, rregullat për mbrojtje të sinjalizuesve. Në vitin i cili është objekt i mbikëqyrjes së Indeksit të transparencës, u miratua Strategjia nacionale për luftë kundër korrupsionit (2021-2025)⁷⁹. Qeveria miratoi edhe Plan për luftë kundër korrupsionit – Aksioni 21⁸⁰ në të cilin janë përfshirë masat për luftë kundër krimit të organizuar, reformat në sistemin zgjedhor dhe të drejtësisë, si dhe ballafaqimi me nepotizmin, kronizmin dhe ndikimin në praktikat për të punësuarit në vendet publike⁸¹. Gjithashtu, në vlerësimin e lartë ndikon arritshmëria e të gjitha politikave përkatëse në ueb faqen e Qeverisë. Pra, në ueb faqen e Qeverisë janë publikuar Kodi për nëpunësit administrativë dhe Kodi i etikës për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria⁸², si dhe është vendosur një seksion i veçantë me informata për mbrojtjen e sinjalizuesve⁸³. Pika negative të indeksit ka marrë sepse nuk ka publikuar Raport vjetor për implementimin e Politikës së integritetit dhe për shkak të mungesës së aktiviteteve edukative për nëpunësit për tema si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Mund të konstatohet se nevojitet një zbatim më i fuqishëm⁸⁴ i politikave që të mund të jepet një vlerësim për

75 Politika për integritet të organeve shtetërore. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/JKKFc86>

76 Indeksi për perceptim të korrupsionit për vitin 2021, Transparency International. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/hKKJVDP>

77 Angazhimet antikorruptive në Maqedoninë e Veriut: strategjitë për ndërtimin e angazhimit konstruktiv. Fondacioni shoqëri e hapur i Maqedonisë viti 2020. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/6KKKJBW>

78 Të dhënat nga fletanketat për gjendjen pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: https://www.dksk.org.mk/imoti_2/

79 Strategjia Nacionale për Luftë Kundër Korrupsionit (2021-2025) me Plan Veprim. Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/CKKKm31>

80 Aksioni 21 – Plani për luftë kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/3KK-KLS8>

81 Indeksi për perceptim të korrupsionit për vitin 2021. Transparency International. E shkarkuar nga: <https://cutt.ly/1KKKBe0>

82 Kodi. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/kodeks>

83 Mbrojtja e sinjalizuesve. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkarkuar nga: <https://vlada.mk/ukazuvaci>

84 GREKO 2021, Raporti për harmonizim i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Rrethi i pesë i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutive dhe zbatimi i ligjit). Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/JKKLvwe>

efikasitetin e tyre, e që do ta ndejnë qytetarët për të cilët korrupsioni është problemi më i madh⁸⁵.

Në aspekt të të arriturave të ministrive, 15 prej tyre kanë informata për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe 7 raportojnë se zyrtarët kanë marrë pjesë në aktivitete edukative për tema si parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesave dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjatë vitit 2021. Këtë vit⁸⁶, gjysma e ministrive kanë publikuar Politikë për integritetin e ueb faqeve, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Tek organet ekzekutive, përmbushja e treguesve të kësaj nënkategorie është dukshëm më e dobët. 54.5% e organeve ekzekutive kanë informata në ueb faqet e tyre për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe vetëm tre institucione (9.1%), identike me vitin e kaluar, kanë njoftuar se nëpunësit kanë marrë pjesë në aktivitete edukative për tema të tilla si parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesave dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjatë vitit 2021. Numri i organeve ekzekutive (17), krahasuar me vitin e kaluar, të cilat raportojnë se kanë politika të brendshme të integritetit, është tre herë më i lartë. Këto të dhëna tregojnë se krahas asaj që është mundësuar kornizë ligjore, duhet të punohet për zbatimin e përforcuar të saj. Zhvillimi i shërbimit publik dhe profesional të bazuar në merita do të rrisë përgjegjshmërinë dhe do të parandalojë politizimin, duke ulur kështu dukshëm rrezikun e konfliktit të interesit dhe korrupsionit.

Shumë e ulët është përqindja e përmbushjes së treguesve nga ana e ministrive (6.25%) dhe organeve ekzekutive (3%) në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e raporteve për realizimin e politikave për integritet dhe/ose cilado politikë e brendshme antikorruptive që parashikon masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike në institucion. Nga ministritë vetëm Ministria e Mbrojtjes⁸⁷ ka publikuar raport për realizimin e Planit për integritet për vitin 2021, ndërsa nga organet ekzekutive të cilat ishin të mbikëqyrur Sekretariati për Legjislacion⁸⁸.

Në aspekt të lobimit si pjesë e kornizës me të cilën është rregulluar në mbikëqyrjet këtë vit ka progres të pjesshëm duke pasur parasysh atë që u miratua Ligj i ri për lobim⁸⁹, me qëllim të parandalimit të ndikimit jolegjitim mbi politikat dhe proceset publike dhe efektet e mundshme korruptive.

Përmes treguesve për integritet pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) është vlerësuar me 52.75 përmbushje të treguesve. Shikuar individualisht, organet ekzekutive edhe në këtë kategori janë në fund në shkallën lidhur me përmbushjen e treguesve të integritetit me 29.55%, më lart janë ministritë me 64.00% përmbushje të treguesve dhe më lart është Qeveria me 64.71% përmbushje të treguesve të internetit.

85 Raporti për vlerësim të korrupsionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Viti 2021. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/pKKLEZE>

86 Në vitin 2020 vetëm Ministria e Vetëqeverisjes Lokale kishte përgatitur dhe publikuar Plan për integritet, faq. 42. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/5KKLDId>


87 Dokumente strategjike. Ministria e Mbrojtjes. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/ZKKL8il>

88 Raporti për planin vjetor për parandalimin e korrupsionit në Sekretariatit e legjislacionit në vitin 2021. Sekretariati I legjislacionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/yKKZfzv>

89 Lobim. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/xKKZlnb>

4.2.5. Të dhënat e hapura

Të dhënat e hapura mbikëqyren në këtë sondazh si shtyllë e përbashkët e qeverisjes së mirë përmes vlerësimit të shkallës së transparencës së të gjitha dokumenteve dhe të dhënave që janë shikuar përmes Indeksit të transparencës. Pasqyra rajonale tregojnë rezultate më të mira për Maqedoninë e Veriut, megjithëse përbush pothuajse 33.14% përbushje të treguesve (individualisht Qeveria përbush 49.5%, ministritë përbushin 34.45% ndërsa organet ekzekutive 31.74% të treguesve për të dhëna të hapura⁹⁰).




Në nivel të politikave, janë krijuar Strategjia e të dhënave të hapura (2018-2020) dhe Plani i Veprimit⁹¹, Ligji për përdorimin e të dhënave të sektorit publik, si dhe Rregullorja e të dhënave të hapura dhe portali i përditësuar i të dhënave të hapura (data.gov.mk), të shoqëruar me udhëzime dhe metodologji të tjera për të mbështetur procesin. Gjithashtu, RMV-ja miratoi Kartën Ndërkombëtare të të Dhënave të Hapura në vitin 2018. Në Plan Veprimin Nacional për Partneritet për Qeveri të Hapur (2021-2023) në të gjitha angazhimet janë masa të ndërthurura për rritjen e grupeve të të dhënave në format të hapur. Është e rëndësishme të theksohet se në plan veprimet paraprake, tema e të dhënave të hapura ishte veçuar, ndërsa tani ajo është horizontale. Për shembull, në plan veprimet paraprake kishte një angazhim të veçantë për të hapur të dhëna për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe të dhëna të hapura për ndryshimet klimatike në nivel nacional dhe lokal. Institucionet raportojnë se u mungon staf i trajnuar për përdorimin dhe publikimin e të dhënave të hapura, dhe është evidente se shoqëria qytetare luan një rol kryesor në zhvillimin e kapaciteteve të sektorit publik në këtë fushë. Si pjesë e Projektit të USAID-it për pjesëmarrjen qytetare, Fondacioni Metamorfozis ka trajnuar 59 nëpunës mbi të dhënat e hapura në vitin 2021

90 Lista e renditjes së institucioneve me shkallë të përbushjes së treguesve të të dhënave të hapura, Aneksi 2.

91 Strategjia e të dhënave të hapura (2018-2020) dhe Plan veprimi. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Shkarkuar nga: <https://cutt.ly/jKKZPYr>

Nga gjithsej 50 institucione që përbëjnë ekzemplarin e institucioneve që u monitoruan nga hulumtimi ynë, vetëm dy ministri (Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës) dhe dy organe ekzekutive (Byroja e Prokurimit Publik dhe Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor) kanë raportuar se nëpunësit e institucioneve të tyre kanë pasur aktivitete edukative/punëtori/trajtime për të dhënat e hapura në vitin 2021. Portali i të dhënave të hapura (data.gov.mk) përmban dy herë më shumë sete të dhënash, në krahasim me matjen paraprake, përkatësisht 550 sete të dhënash të publikuara nga 72 organizata, shumica prej tyre nga institucione apo agjenci të nivelit ekzekutiv. Fondacioni Metamorfozis gjithashtu trajnon vazhdimisht institucionet për të hapur setet e të dhënave të tyre dhe përmes kësaj mbështetjeje u krijuan 30 grupe të dhënash nga 10 institucione në nivel qendror. Aktualisht, Fondacioni Metamorfozis bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut; Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor, për hapjen e grupeve të të dhënave



Fondacioni Metamorfozis, në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informative dhe Administratës, dhe përmes Projektit të USAID-it për pjesëmarrje qytetare, siguroi mbështetje teknike për përgatitjen e draft-ligjit të ri për përdorimin e të dhënave të sektorit publik, që së shpejti duhet të dorëzohet në RVNE.

4.2.6. Konkluzion

Konkluzion i përgjithshëm që del nga institucionet e mbikëqyrura në Indeksin e transparencës, që përsëritet disa vite me radhë, është ekzistimi i korrelacionit të drejtpërdrejtë ndërmjet hierarkisë së institucioneve dhe rënies së vlerësimeve të tyre. Që do të thotë se angazhimi dhe zbatimi i standardeve për transparencë janë në nivel të ndryshëm të strukturat e ndryshme të pushtetit ekzekutiv dhe prandaj koncepti i transparencës doemos duhet të zgjidhet në mënyrë sistemore.

Këtë vit rezultati i përgjithshëm i pushtetit ekzekutiv (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) arrin 60.93% përmbushje të treguesve të transparencës. Organet ekzekutive kanë rezultat më të ulët sipas Indeksit, përkatësisht 41.54% përmbushje të treguesve, krahasuar me mesataren e ministrive që përmbushin 58.56% dhe Qeveria e cila ka rezultat të përgjithshëm më të lartë dhe atë 82,71% përmbushje të treguesve.

Në nënkategoritë e pushtetit ekzekutiv ka çmim më të lartë për treguesit për transparencë prej 55.65%, pastaj me 54.66% të përmbushjes është në nënkategorinë efikasitet, vijon 52.75% përmbushje në nënkategorinë integritet dhe vlerësim më i ulët për qasshmëri prej 51.09%. Duke pasur parasysh se treguesit për qasshmëri e vlerësojnë shkallën deri në të cilën e drejta e qasjes në informatat është garantuar me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësia e mekanizmave për përfshirje dhe konsultime gjatë proceseve të krijimit të politikave shumica e rekomandimeve që ky dokument i thekson, në fakt, kërkojnë implementim efikas të politikave ekzistuese nga ministritë dhe organet ekzekutive.

Nga 33 organe të mbikëqyrura ekzekutive, pothuajse 1/3 (9 organe ekzekutive) nuk kanë ueb faqe dhe në masë të madhe mbështeten në institucionin përkatës për mbikëqyrje për dukshmërinë e punës së tyre. Është evidente se sa më e lartë hierarkia e institucionit, aq më të mëdha janë gjasat që ai të investojë mjete për dukshmërinë e punës së tij dhe për marrëdhëniet me publikun. Hulumtimi, gjithashtu, kërkon lidhshmëri të drejtpërdrejtë ndërmjet rezultateve të ministrive dhe vlerësimeve të agjencive që i mbikëqyrin, por kjo nuk ishte e dukshme. Prandaj, politikat qendrore si Strategjia për transparencë dhe Strategjia për komunikime e Qeverisë dhe standardet e përcaktuara minimale për transparencë publike dhe llogaridhënie, duhet të pranohen dhe implementohen nga të gjitha institucionet e pushtetit qendror.

Përsëritet edhe konkluzioni se me rëndësi të madhe është të bëhet dallimi ndërmjet cilësisë së kornizës juridike në vend dhe zbatimit. Mekanizmat për zbatim, ndjekje dhe njoftim janë po aq të rëndësishme për t'u siguruar efektiviteti i këtyre politikave dhe për ruajtjen e rezultateve të tyre pozitive, si dhe vetë tekstet. Prandaj, është me rëndësi që proceset reformuese të planifikohen në mënyrë thelbësore dhe sistematike, duke i adresuar virablat e ndryshme që kontribuojnë për problemin, në vend që të realizohen intervenimet sipërfaqësore.

Indeksi i transparencës është mjet adekuat sipas të cilit pushteti, por edhe çdo institucion veçmas, mund të udhëhiqet prej tij për ta avancuar qeverisjen e tij të mirë. Ueb faqet janë burim të verifikueshëm më së lehti në mënyrë legjitime i informatave për transparencë, si dhe mjet për bashkëveprim me dhe llogaridhënie para publikut dhe doemos të përdoren në mënyrë efikase për t'u kumtuar të gjitha aspektet e kompetencave të institucioneve përkatëse. Fokusi i institucioneve doemos duhet të jetë në publikimin proaktiv të të gjithë

dokumente në formatin e arritshëm më të hapur. Si rrjedhojë, ueb faqet duhet të zënë pozitë qendrore në të gjitha politikat për transparencë të institucioneve me qëllim për ta përmirësuar arritshmërinë, si dhe cilësinë e informatave dhe të dhënave. Njëkohësisht, është koha që të gjitha organet ekzekutive të krijojnë hapësirë të tyre online (ueb faqe të pavarura ose pjesë e veçantë e ueb faqeve të ministrive të tyre resore) ku këmbëjnë dhe përditësojnë informata dhe komunikojnë me qytetarët.

Si konkluzion, përveç dallimeve evidente në definimin e konceptit për qeverisje të mirë, ekziston konsensus i përgjithshëm ndërmjet teoricienëve dhe praktikuesve se qeverisja e mirë, e definuar si sistem që u përgjigjet nevojave të njerëzve, është e lidhur pozitivisht me besimin e publikut në institucionet. Besimi i publikut në institucionet është rezultat i zbatimit të politikave për qeverisje të mirë, por edhe parakusht për qeveritë që të mund të ndërmarrin reforma strukturore dhe thelbësore, të cilat i nevojiten vendit. Prandaj, nevoja parësore për mbikëqyrjen e parimeve për qeverisje të mirë të çdo Qeverie dhe njësive të saj shpesh është e fokusuar në sigurimin e legjitimitetit dhe besimit të publikut të cilit i shërbejnë dhe e përfaqësojnë. Rritja e besimit të publikut në paanshmërinë e institucioneve dhe nëpunësve të tyre publike, të bazuara në integritet, do ta çojë Qeverinë në qëllimin për ta siguruar dhe për ta ruajtur legjitimitetin e saj.

4.2.7. Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë për pushtetin ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Transparenca

- Të gjithë organet ekzekutive doemos duhet të kenë ueb faqe të tyre ose të vendoset pjesë e veçantë në ueb faqen e ministrive resorë, me qëllim të mundësojnë transparencë aktive, bashkëveprim të drejtpërdrejtë me publikun dhe llogaridhënie. Të mundësohen kërkues funksionalë në ueb faqet e organeve ekzekutive.
- Institucionet të fusin procedura të brendshme të cilat do ta avancojnë procesin e transparencës reaktive por edhe aktive, me afate të vendosura dhe persona përgjegjës për ndarje dhe përditësim të informatave të ueb faqeve.
- Institucionet të publikojnë detyrimisht programe vjetore për punë dhe të publikojnë rregullisht raporte për punën e tyre. Të shpeshtohet me përgatitjen dhe publikimin e raporteve tremujore ose gjysmë vjetore.
- Qeveria duhet t'i publikojë dokumentet që shqyrtohen dhe diskutohen gjatë seancave, si dhe transkriptat nga seancat. Nga ana tjetër, audio dhe ose video transmetim të seancave që do t'i japë qasje të drejtpërdrejtë publikut për ta ndjekur miratimin e vendimeve për politikat që ndikojnë drejtpërdrejt mbi to, do të jetë praktikë e mirë plotësuese që duhet të merret parasysh.

- Qeveria duhet të realizojë konsultime me publikun gjatë planifikimit të buxhetit, si dhe të publikojë informata në ueb faqen për shpenzimin e rezervave buxhetore.
- Qeveria ta dorëzojë Draft-ligjin për Buxhetin në Kuvendin minimum tre muaj para fundit të vitit fiskal që të sigurohet kohë të mjaftueshme për shqyrtim efektiv.
- Institucionet doemos duhet të publikojnë rregullisht plane të tyre buxhetore dhe raporte financiare vjetore dhe gjysmëvjetore.
- Të rregullohet mundësia që nëpunësit që realizojnë prokurime publike të jenë të obliguar të plotësojnë deklaratë për konflikt interesash dhe të parashtrajnë fletanketë për gjendjen pronësore.
- Të publikohen pronarët e vërtetë të ofertuesve dhe firmave që paraqiten në thirrjet për prokurime publike dhe të atyre që kanë lidhur marrëveshje me institucionet në procedurën për prokurim publik. Të vendoset regjistër të pronarëve të vërtetë.
- Institucionet t'i lidhin të dhënat lidhur me prokurimet publike (me link) të cilët janë vendosur në Sistemin elektronik për prokurime publike me ueb faqet e tyre.
- Të ndërmerren masa konkrete nga institucionet në standardizimin e prokurimeve publike.

Qasshmëria

- Institucionet t'i publikojnë në ueb faqen e tyre përgjigjet me të cilat kanë siguruar qasje në informatat pas kërkesës së parashtruar (nga qasja reaktive në aktive) me çka do të zvogëlohet përsëritja e kërkesave të marra me shkrim për informatat e njëjta.
- Institucionet duhet doemos që ta publikojnë në mënyrë proaktive setin e dokumenteve, të dhënave dhe informatave të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik me çka do të ndikojnë në rritjen e transparencës aktive.
- Të ulet afati maksimal për përgjigjen e kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik nga 20 deri në 15 ditë, duke marrë parasysh se ajo është periudhë e arsyeshme e pritjes sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikës së vendosur rajonale.
- Organet ekzekutive të fusin hapësirë të veçantë (seksion) në ueb faqet kushtuar procedurës me kërkesat për qasje të lirë në informatat.
- Nëpunësit të jenë të trajnuar rregullisht për standardet ndërkombëtare dhe vendore për avancimin e qasjes në informatat, e që do të ndikojë edhe në rritjen e shkallës së përgjigjeve dhe cilësisë së përgjigjeve të kërkesave.

- Institucionet duhet të fusin kanale të drejtpërdrejta në ueb faqet për komunikim online me qëllim për të mundësuar bashkëveprim më të lehtë me qytetarët. Kanalet të sigurojnë mundësi për qytetarët që të dërgojnë parashtrësia dhe propozime.
- Ueb faqet duhet të sigurojnë udhëzime të qarta dhe t'i promovojnë mekanizmat e arritshme për ngritje të ankesave.
- Institucionet, paralelisht me avancimin e ueb faqeve, nevojitet që ta përmirësojnë prezencën e tyre në mediat sociale përmes publikimit të rregullt të informatave të servisit për publikun, dhe t'i orientojnë në rritjen e vetëdijes për të drejtat, proceset dhe mekanizmat të cilat nuk janë aq të njohura te publiku i gjerë.
- Institucionet, në veçanti organet ekzekutive, në ueb faqen të publikojnë lista me shërbime të cilat i ofrojnë, si dhe në vend të dukshëm të vendosin link në portalin www.uslugi.gov.mk. Gjithashtu, institucionet ta rrisin promovimin e portalit www.uslugi.gov.mk në mediat sociale.
- Proceset e krijimit të politikave duhet të planifikohen paraprakisht dhe prandaj duhet të jenë të parashikueshme, përkatësisht planet vjetore për konsultime me palët e interesuara duhet të publikohen në ueb faqet. Përveç kësaj, këto plane duhet të ndahen dhe shpërndahen tek palët e interesuara në kohë, si dhe të promovohen në mënyrë që publiku të mund ta dijë afatin kohor, të planifikojë dhe të përgatitet për proceset e ardhshme të krijimit të politikave. Komunikimi efektiv dhe në kohë me publikun në lidhje me proceset e konsultimeve publike është shumë i rëndësishëm për marrjen e kontributit thelbësor nga palët e interesuara.
- Institucionet të vendosin në ueb faqet pjesë të veçantë me informatat e nevojshme për paralajmërimin e proceseve të krijimit të politikave me link të drejtpërdrejtë në RVNE.
- Është e domosdoshme të vendoset kontroll të cilësisë së konsultimeve publike. Që të sigurohet besim në procesin e konsultimeve dhe të nxitet pjesëmarrja, institucionet duhet të japin informata kthyesë nga konsultimet, përkatësisht të krijojnë procesverbale nga proceset konsultative, si aktivitet vijues me arsyetim pse disa propozime nuk janë pranuar.

Efikasiteti

- Institucionet të përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit dhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.
- Është i domosdoshëm zbatimi i rolit të Sekretariatit të Përgjithshëm për kontrollin e cilësisë dhe ndjekjen e zbatimit të politikave ekzistuese.
- Qeveria duhet të zvogëlojë trendin e numrit të propozim-ligjeve që propozohen me procedurë të shkurtuar për të mos rrezikuar cilësinë e tyre dhe/ose për të zvogëluar pjesëmarrjen e palëve të interesuara në konsultime.

- Qeveria duhet të shmangë ndryshimet e politikave pa dëshmi se ndryshimet e propozuara do të ofrojnë përmirësime të konsiderueshme. Nevojitet angazhim dhe vendosje të praktikës për kryerjen e analizave ex ante dhe ex post.
- Të gjitha institucionet duhet ta përmirësojnë përdorimin konsekuent të të dhënave për qëllime administrative dhe mbi to ta bazojnë planifikimin dhe njoftimin e tyre.

Integriteti

- Institucionet duhet të punojnë me shpejtësi në përgatitjen e Politikës së integritetit, që pritet të publikohet në ueb faqet e tyre, si dhe t'i përkushtohen përgatitjes dhe publikimit të raporteve për zbatimin e politikave të integritetit.
- Institucionet duhet t'i shpeshtojnë dukshëm aktivitetet edukative për nëpunësit për tema si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve.
- Është i domosdoshëm avancimi i sistemit për monitorimin e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Avancimi i formatit në të cilin publikohen deklaratat për pronën në format të hapur. Përforcimi i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për të mundësuar arritshmëri publike të deklaratave për pronën edhe pas ndërprerjes së kohës në të cilën kryhet funksioni.
- Nevojitet përforcimi i instrumenteve për monitorim dhe njoftim në lidhje me kornizën juridike dhe politike në këtë fushë, në mënyrë që të gjenerohen të dhëna për zbatimin e saj dhe të rritet besimi në sistem.

Aneksi 1: Lista e renditjes e institucioneve me shkallë të përmbushjes së treguesve të transparencës

QEVERIA DHE MINISTRIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	% E PËRMBUSHJES SË TREGUESVE TË TRANSPARENCËS
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	82,71%
Ministria e Mbrojtjes	81,88%
Ministria e Punëve të Brendshme	76,1%
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	71,81%
Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës	71,06%
Ministria e Financave	71,06%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	67,15%
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	67,15%
Ministria e Ekonomisë	61,74%
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	58,19%
Ministria e Punëve të Jashtme	52,59%
Ministria e Kulturës	50,91%
Ministria e Shëndetësisë	49,61%
Ministria e Drejtësisë	48,3%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	46,81%
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	41,59%
Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve me Bashkësitë	21,06%

ORGANE EKZEKUTIVE	% E PËRMBUSHJES SË TREGUESVE TË TRANSPARENCËS
Sekretariati i Legjislacionit	71,47%
Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit	69,23%
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	69,21%
Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë	66,49%
Enti Shtetëror i Statistikës	65,14%
Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor	61,97%
Inspektorati Shtetëror i Punës	60,61%
Byroja e Prokurimit Publik	61,52%
Komisioni për Marrëdhëniet me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze	61,52%
Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	60,16%
Byroja e Zhvillimit Rajonal	58,8%
Agjencia e Barnave dhe Mjeteve Mjekësore	51,11%
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor	49,3%
Drejtoria e Policisë Financiare	50,66%
Drejtoria e Zbulimit Financiar	41,61%
Agjencia e emigrimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut	41,15%
Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	40,72%
Agjencia e Rezervave të Mallrave	39,37%
Agjencia e të Rinjve dhe Sportit	38,89%
Sekretariati për Çështje Evropiane	38,21%
Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve	37,08%
Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik	34,82%
Byroja e Ekspertizës Ligjore	33,91%
Shërbimi pedagogjik	30,77%
Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike	25,32%
Byroja e Metrologjisë	24,43%
Drejtoria e Çështjeve të Luftëtarëve dhe Invalidëve të Luftës	23,53%
Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve	18,1%
Drejtoria e Ekonomisë së Ujërave	17,19%
Drejtoria e Farës dhe Materialit Faror	15,38%
Drejtoria e Zhvillimit dhe Avancimit të Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Komuniteteve	7,24%
Kapiteneria e portit	3,62%
Shërbimi i Sistemit Informativ Hapësinor	2,26%

Aneksi 2: Lista e renditjes e institucioneve me shkallë të përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura

QEVERIA DHE MINISTRIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	% E PËRMBUSHJES SË TREGUESVE TË THËNA TË HAPURA
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	49,5%
Ministria e Mbrojtjes	53,78%
Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës	45,1%
Ministria e Punëve të Brendshme	45,1%
Ministria e Financave	42,9%
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	40,7%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	37,4%
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	36,3%
Ministria e Shëndetësisë	35,54%
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	35,2%
Ministria e Kulturës	31,9%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	29,7%
Ministria e Ekonomisë	28,6%
Ministria e Drejtësisë	25,3%
Ministria e Punëve të Jashtme	24,2%
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	24,2%
Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve me Bashkësitë	15,23%

ORGANE EKZEKUTIVE	% E PËRMBUSHJES SË TREGUESVE TË THËNA TË HAPURA
Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	52,8%
Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit	50,16%
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	50,16%
Komisioni për Marrëdhëniet me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze	49,5%
Sekretariati i Legjislacionit	48,84%
Byroja e Zhvillimit Rajonal	47,52%
Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë	44,88%
Enti Shtetëror i Statistikës	44,88%
Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor	47,52%
Inspektorati Shtetëror i Punës	42,24%
Agjencia e Barnave dhe Mjeteve Mjekësore	42,24%
Byroja e Prokurimit Publik	39,6%
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor	39,6%
Shërbimi pedagogjik	36,96%
Drejtorja e Policisë Financiare	34,32%
Sekretariati për Çështje Evropiane	31,68%
Drejtorja e Zbulimit Financiar	31,68%
Agjencia e Emigrimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut	31,68%
Agjencia e Rezervave të Mallrave	29,04%
Agjencia e Rinjve dhe Sportit	29,04%
Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	28,7%
Byroja e Ekspertizës Ligjore	27,72%
Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik	26,4%
Byroja e Metrologjisë	23,76%
Drejtorja për Punë Hidrometeorologjike	22%
Drejtorja e Ekzekutimit të Sanksioneve	21,12%
Drejtorja e Çështjeve të Luftëtarëve dhe Invalidëve të Luftës	21,12%
Drejtorja e Mbrojtjes së Bimëve	18,48%
Drejtorja e Farës dhe Materialit Faror	17,88%
Drejtorja e Ekonomisë së Ujërave	7,92%
Drejtorja e Zhvillimit dhe Avancimit të Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Komuniteteve	2,64%
Kapiteneria e portit	2,64%
Shërbimi i Sistemit Informativ Hapësinor	2,64%

Fondacioni Metamorfozis për internet dhe shoqëri është fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Misioni i saj është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe në rritjen e cilësisë së jetës përmes shfrytëzimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive.

Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Sferat programore në të cilat punon Metamorfozis:

- Mediat për demokraci
- Edukimi për inovacione
- Përgjegjësia shoqërore
- Të drejtat e njeriut në internet

Fondacioni Metamorfozis për internet dhe shoqëri
Rr. „Apostoll Gusllarot” nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

e-mail: info@metamorphosis.org.mk

tel: +389 2 3109 325

www.metamorphosis.org.mk

